



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr ____prot

Tiranë më _____.____.2024

**VENDIM
Nr. 396, datë 30.07.2024
PËR**

VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...}, PËR VITIN 2022

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për vitin 2022”, i hartuar nga relatore znj. Irena Plaku,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për vitin 2022”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PËRCAKTIMI I NIVELIT TË VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarës {...} në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarës bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtarës pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1.A NJOHURITË LIGJORE.

1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Përcaktimi i objektit të mosmarrëveshjes që i paraqitet gjykatës për zgjidhje është në disponibilitetin ekskluziv të palëve, por nga ana tjetër në mbështetje të nenit 16 të K.Pr.Civile është gjykata ajo që bën një cilësim të saktë të fakteve që lidhen me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi dhe për rrjedhojë nuk është e lidhur as me bazën apo referencën ligjore të palës paditëse.

Sa më sipër, roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, fakt ky i cili do të përcaktojë edhe natyrën juridike të saj, e për pasojë edhe referencën relevante për zbatim në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në vijim, analizohet mënyra se si janë evidentuar këta elementë ligjor në vendimet burim vlerësimi për gjyqtaren {...}.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

- Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes

Referuar objektit të mosmarrëveshjes dhe natyrës së çështjes, konstatohet se në vendim burim vlerësimi¹, përgjithësisht gjyqtarja nuk i kushton rëndësi përshkrimit të fakteve të

¹ Vendimi nr.989, datë 28.02.2022, Vendimi nr.2486, datë 09.05.2022, Vendimi nr. 4960, datë 03.10.2022, Vendimi nr. 6123, datë 21.11.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë etj

çështjes si atyre me natyrë procedurale ashtu edhe ato që lidhem me rrethanat të atyre me natyrë procedurale, ashtu edhe të fakteve që lidhen me themelin. Konstatohet se përgjithësisht gjyqtarja e fillon arsyetimin e vendimit me parashtrimin e pretendimeve të palëve lidhur me faktet dhe arsyetimin ligjor të pretendimeve të tyre, të cila paraqiten përgjithësisht në mënyrë të detajuar, duke zënë një pjesë konsiderueshme të vendimit. Por konstatohet se në disa vendime², gjyqtarja menjëherë pasi përshkruan padinë me të cilën pala paditëse i është drejtuar gjykatës dhe në dy raste pasi ka përshkruar shkurtimisht ecurinë procedurale të çështje, ka përshkruar disa nga rrethanat dhe faktet e çështjes në mënyrë të përmbledhur (pra jo të gjitha faktet e çështjes), duke i integruar në disa raste edhe me provat e marra në shqyrtim. Në të gjithë këto vendime burim vlerësimi konstatohet se faktet e çështjet përshkruhen dhe analizohen në raport me njëra tjetrën tek pjesa e analizës juridike, duke i gërshetuar edhe me aktet provuese që provojnë faktet konkret, fakte këto që nuk janë përshkruar më parë në fillim të pjesës përshkruese – arsyetuese, rrethanë kjo që nuk i jep qartësi vendimin për faktet e provuara në gjykim. Ndërsa në lidhje me faktet procedurale të çështjes, rezultoi se ato përgjithësisht nuk janë përshkruar dhe arsyetuar në vendimet burim vlerësimi, si vlerësimi në lidhje me juridiksionin gjyqësor, kompetencën lëndore dhe tokësore, dhe as në lidhje me ecurinë procedurale të çështjes lidhur me paraqitjen dhe shqyrtimin e kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë³, të kërkesës për saktësimin apo shtimin e objektit të padisë, të cilat duken se janë marrë në shqyrtim gjatë procesit. Në disa vendime konstatohet se gjykata vetëm ka përshkruar disa nga këto rrethana, pa bërë një analizë ligjore të tyre, konkretisht faktin se çështja ka ardhur për kompetencë lëndore nga gjykata administrative e shkallës së parë Tiranë⁴, duke cituar në vendim edhe arsyetimin e bërë nga kjo gjykatë (pa bërë vetë një analizë nëse vlerëson se ka ose jo kompetencën lëndore për shqyrtimin e saj), faktin se gjykata në referim të nenit 42 e vijues të KPRC është kompetente për shqyrtim e padisë⁵, faktin se bazuar në nenin 41 dhe 46 të KPRC çështja është në juridiksionin gjyqësor dhe gjykata ka kompetencë lëndore, funksionale e tokësore në gjykimin e padisë, bazuar në nenin 35 çështja është gjykuar nga një gjyqtar, faktin se për të nuk ka shkaqe papajtueshmërie, se gjatë gjykimit pala paditëse ka saktësuar objektin e padisë (duke cituar atë)⁶, faktin se pasur parasysh vendimin e gjykatës së apelit (duke cituar detyat e lënë nga kjo gjykatë), gjyqtarja ka bërë rregullimin e ndërgjyqësisë, duke thirrur një person të tretë, objektin e padisë në saktësimin e kërtimeve, janë sjellë prova nga palët ndërgjyqëse, si dhe është marrë dhe kartela e pasurisë objekt gjykimi⁷ si dhe faktin se gjatë gjykimit nga pala paditëse është bërë rregullimi i ndërgjyqësisë sipas nenit 161 të KPRC, kërkesë e cila është pranuar nga gjykata (pa bërë një përshkrim lidhur me këto vendimmarrje të gjykatës dhe një analize juridike).

- Lidhur me identifikimin e natyrës së çështjes.

² Vendimi nr.1170, datë 07.03.2022, vendimi nr.4858, datë 28.09.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

³ Vendimi nr. 4960, datë 03.10.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁴ Vendimi nr.989, datë 28.02.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁵ Vendimi nr.4858, datë 28.09.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁶ Vendimi nr.1170, datë 07.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁷ Vendimi nr.4960, datë 03.10.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

Nga identifikimi dhe përshkrimi i saktë i faktit juridik (i cili jo gjithmonë përshkruhet nga gjyqtarja në pjesën e parë të pjesës përshkruese- arsyetuese të vendimit dhe në ato raste kur përshkruhet nuk është i plotë), gjyqtarja krijon idenë e saj rreth natyrës së marrëdhënies juridike për shkak të së cilës ka lindur mosmarrëveshja midis palëve. Përcaktimit të saktë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve i jepet rëndësia e duhur nga ana e gjyqtarës tek pjesa e analizës juridike, duke u bërë përgjithësisht në mënyrë të shprehur, e në disa raste, si pasojë e një analize ligjore të shkakut dhe objektit të padisë.

Pas përcaktimit të natyrës së marrëdhënies juridike, gjyqtarja përcakton drejt edhe institutin juridik përkatës të çështjes civile (*nëse jemi para një mosmarrëveshje juridike civile detyrimi, pavlefshmëri titulli juridik, pavlefshmëri testamenti, marrëdhënie pune apo shpërblim dëmi etj*). Nga vlerësimi i vendimeve të përzgjedhura nga vetë gjyqtarja dhe atyre të përzgjedhura me short, vihet re që natyra juridike e çështjes është evidentuar pothuajse në të gjitha çështjet e trajtuara, por edhe ku nuk është identifikuar në mënyrë specifike, del qartë referuar identifikimit të elementeve dhe kritereve ligjore të mosmarrëveshjes juridike.

- Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm

Përcaktimi i saktë i natyrës së çështjes nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë vetëm me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës për shqyrtimin e çështjes (të cilat siç u tha më lartë përgjithësisht nuk janë marrë në shqyrtim në mënyrë të shprehur nga ana e gjyqtarës), por lidhet gjithashtu edhe me identifikimin e ligjit të zbatueshëm procedural dhe material në zgjidhjen e çështjes. Në këtë drejtim, rezulton se në të gjitha vendimet, gjyqtarja identifikon ligjin e zbatueshëm që ajo referon në zgjidhjen e çështjes, citon dispozita të ligjit material ose procedural, si dhe analizon përmbajtjen e tyre, kur është vlerësuar e nevojshme, në mënyrë të integruar me faktin, ose në disa raste në mënyrë të pavarur, para aplikimit mbi faktet e çështjes.

Sa i përket ligjit procedural:

Gjyqtarja identifikon dhe referon në pjesën arsyetuese të vendimit, dispozitat procedurale, si më poshtë:

- nenet 41, 46, 35, 31, 32, 71, 72, 73 të K.Pr.Civile lidhur me kompetencën lëndore, tokësore, përbërjen e trupit gjykues, legjitimitimin procedural formal, mungesën e shkaqeve të përjashtimit dhe papajtueshmërisë⁸;
- nenet 61, 52 dhe 62 të K.Pr.Civile lidhur me subjektin procedural që legjitimohet të paraqes kërkesën për mungesën e kompetencës tokësore; lidhur me mungesën me shkrim të të palëve ndërgjyqëse për të përcaktuar kompetencën e gjykatës në rast mosmarrëveshje si dhe lidhur me të drejtën e ankimit në rast deklarimi të moskompetencës⁹;
- nenin 254 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me qenien si provë të plotë të aktit administrativ, vendimi i Inspektoratit të Punës¹⁰;

⁸ Vendimi nr. 1170, datë 07.03.2022; Vendimi nr. 3766, datë 06.07.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁹ Vendimi nr. 3766, datë 06.07.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹⁰ Vendimi nr. 4858, datë 28.09.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

- nenet 126 dhe 306 të Kodit të Procedurës Civile për shpalljen e vendimit përfundimtar¹¹ ;
- nenin 185 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me ndryshimin e objektit të padisë dhe nenin 158/7 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me pretendimet e pangritura në padi dhe as në vijim të deklaratës së mbrojtjes, por vetëm në seancë përgatitore, të cilat nuk pranohen më pas nga gjykata¹²;
- nenet 202, 317 të K.Pr.Civile lidhur me sigurimin e padisë dhe dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm¹³ ;
- nenin 510 e vijues të Kodit të Procedurës Civile lidhur me ekzekutimin nga përmbaruesi gjyqësor¹⁴;
- nenin 617 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me të drejtën e kreditorit që pasi është vendosur pushimi i ekzekutimit të bëjë një kërkesë të re për vënie në ekzekutim brenda periudhës së parashkrimit¹⁵;
- neni 609 i Kodit të Procedurës Civile lidhur me pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv¹⁶ dhe nenet 610, 612 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me paditë mbrojtëse gjatë fazës së ekzekutimit të tilla si pavlefshmëria e titullit ekzekutiv, kundërshtimi i veprimeve përmbarimore dhe padia e pronarit të sendit gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm¹⁷;
- nenin 161 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me ndërgjyqësinë e detyruar¹⁸;
- nenin 32/b të Kodit të Procedurës Civile lidhur me padinë e njohjes pronar¹⁹;
- nenin 578 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me padinë për veçimin e pjesës takuese të debitorit bashkëpronar mbi sendin që do të bëhet ekzekutimi²⁰;
- nenin 614 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me mënyrën e trajtimit të sendit të paluajtshtëm të shitur në ankand, kur bëhet njohja juridike e së drejtës së pronësisë së paditësit pronar ndaj blerësit të sendit apo kreditorit të procedurës së kredisë dhe kthimin e pronës tek pronari real i saj²¹;
- nenin 580 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me kundërshtimin e pronësisë së sendit të shitur në ankand e të veprimeve të përmbaruesit gjyqësor që t'i japë mundësinë të tretit të kërkojë sendin e tij me padi edhe pas shitjes²²;
- nenin 212 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me ligjërimin e masës së sigurimit të padisë të vendosur nga gjykata²³ ;
- neni 74 i K.Pr.Civile lidhur me të drejtën e palës për të kërkuar përjashtimin e gjyqtarit kur heqja dorë është e detyrueshme dhe procedura që ndiqet për përjashtimin e tij dhe neni 72 i K.Pr.Civile lidhur me rastet kur gjyqtari është i detyruar të japë dorëheqjen nga gjykimi i një çështje konkrete²⁴

¹¹ Vendimi nr. 4858, datë 28.09.2022; Vendimi nr. 989, datë 28.02.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹² Vendimi nr. 6123, datë 21.11.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹³ Vendimi nr. 1170, datë 07.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹⁴ Vendimi nr. 6123, datë 21.11.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹⁵ Vendimi nr. 6123, datë 21.11.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹⁶ Vendimi nr. 6123, datë 21.11.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹⁷ Vendimi nr. 4960, datë 03.10.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹⁸ Vendimi nr. 2486, datë 09.05.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹⁹ Vendimi nr. 4960, datë 03.10.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

²⁰ Vendimi nr. 4960, datë 03.10.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

²¹ Vendimi nr. 4960, datë 03.10.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

²² Vendimi nr. 4960, datë 03.10.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

²³ Vendimi nr. 4960, datë 03.10.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

²⁴ Vendimi nr. 479 datë 12.04.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

- neni 106 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me shpenzimet gjyqësore²⁵;
- nenin 70 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me efektet e një vendimi penal për gjykimin civil ku shqyrtohen pasojat e veprës, si i detyrueshëm vetëm sa i përket faktit nëse vepra është kryer dhe nëse është kryer nga i gjykuari ²⁶.

Sa i përket ligjit material të zbatueshëm, referuar burimeve të vlerësimit në tërësinë e tyre, rezulton se përgjithësisht gjyqtarja identifikon dhe/ose citon dispozitat materiale të cilat gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes objekt shqyrtimi. Në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material, konstatohet se:

Gjyqtarja identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, duke iu referuar si dispozitave materiale të Kodit Civil, ashtu edhe ligjeve të posaçme apo akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës, lidhur me:

- *Dëmshpërblim për shkak të aksidentit të ndodhur në punë*²⁷ gjyqtarja identifikon nenet 419 të Kodit Civil lidhur me kuptimin e detyrimit; nenet 23, 32, 39 të Kodit të Punës lidhur me detyrimin e punëmarrësit të mos zbatojë urdhërat dhe udhëzimet e përgjithshme dhe të veçanta të punëdhënësit që rrezikojnë jetën dhe shëndetin e tij; detyrimin e punëdhënësit për të garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit fizik dhe mendor të punonjësve dhe për të parandaluar aksidentet dhe sëmundjet profesionale duke përcaktuar qartë rregulla të sigurimit teknik; nenet 476, 480 të Kodit Civil si rregulla të përgjithshme mbi detyrimet; nenet 690, 698 të Kodit Civil si dispozita të posaçme në kuadër të kontratave që i japin mundësi palës kontraktore që të kërkojë shpërblim dëmi të shkaktuar saj nga mosekzekutimi/mangësi të detyrimeve kontraktore të marra përsipër nga pala tjetër; nenin 608 e vijues të Kodit Civil lidhur me konceptin e përgjegjësisë në shkaktimin e dëmit jashtëkontraktor dhe dëmshpërblimit të tij, kushtet për lindjen e përgjegjësisë në shkaktimin e dëmit dhe ku konsiston ky dëm, mënyra e shpërblimit të tij.
- *Dëmshpërblim për shkak të përdorimit të sendit*²⁸ gjyqtarja identifikon nenet 162 e vijues të Kodit Civil lidhur me mënyrat e fitimit dhe humbjes së pronësisë; nenin 296 e vijues të Kodit Civil lidhur me padinë e kërkimit të sendit (padija e rivendikimit), padinë mohuese, padinë e kallëzimit të një punimi të ri; nenet 297, 298 të Kodit Civil lidhur me të drejtat e poseduesit për të ardhurat në varësi të të qenurit posedues me mirëbesim dhe keqbesim; nenet 304, 305, 306 të Kodit Civil lidhur me kuptimin e posedimit, llojet e tij; nenin 191 të Kodit Civil lidhur me humbjen e pronësisë në rast fitimi nga një tjetër.
- *Detyrim njohje pronar*²⁹ gjyqtarja identifikon nenet 169, 170, 171, 1168 të Kodit Civil lidhur me parashkrimin fitues pa titull, kushtet e tij, legjitimiti aktiv dhe pasiv, ndërprerjes së parashkrimit fitues, dhe koha kur ka hyrë ai në fuqi në Republikën e Shqipërisë; Dekretin nr. 2083, datë 06.07.1956 „Mbi pronësinë,“ dhe nenet 91 e 92 të Kodit Civil të vitit 1982; nenet 304, 312, 313 të Kodit Civil lidhur me posedimin dhe paditë posedimore.

²⁵ Vendimi nr. 6123, datë 21.11.2022; Vendimi nr. 1170, datë 07.03.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

²⁶ Vendimi nr. 4858, datë 28.09.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

²⁷ Vendimi nr. 4858, datë 28.09.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

²⁸ Vendimi nr. 989, datë 28.02.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

²⁹ Vendimi nr.2486, datë 09.05.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

- *Detyrim njohje bashkëpronar dhe kthimin e pasurive në gjendjen e mëparshme*³⁰ gjyqtarja identifikon nenin 349 të Kodit Civil lidhur me padinë e kërkimit të trashëgimit/pasurisë trashëgimore; nenin 163 të Kodit Civil lidhur me mënyrat e fitimit të pronësisë; nenin 296 të Kodit Civil lidhur me padinë për kërkimin e sendit; neni 318 të Kodit Civil lidhur me momentin e çeljes së trashëgimisë në kohën e vdekjes së trashëgimlënësit; nenet 86 e 87 të Kodit Civil të vitit 1981 në lidhje me nenet 1167 të Kodit Civil të vitit 1994 dhe neni 231 të Kodit të Familjes lidhur me rregullimin e bashkëpronësisë midis bashkëshortëve dhe prezumimin e barazisë së pjesëve.
- *Pavlefshmëri testamenti dhe njohjen e si trashëgimtar i vetëm i testamentit*³¹ gjyqtarja identifikon nenet 316 -318, 327, 330, 333, 349-350, 361, 372-373 të Kodit Civil lidhur me kuptimin e trashëgimisë, trashëgiminë ligjore, momentin e çeljes së trashëgimisë dhe ligjin e zbatueshëm, zëvendësimi në trashëgim, momenti kur fitohet trashëgimia, heqja dorë nga trashëgimia, padia e kërkimit të trashëgimit/pasurisë trashëgimore dhe legjitimimi i palëve, radha e trashëgimtarëve ligjorë, kuptimi i testamentit dhe kushtet për të qenë testator; neni 377 i Kodit Civil lidhur me të drejtën e trashëgimlënësit që nuk lë të paslindur ose të paralindur, ose vëllezër dhe motra të disponojë me testament pasurinë e vet në favor të çdo personi fizik ose juridik; nenet 402, 406 të Kodit Civil lidhur me testamentin në një datë të mëvonshme, pavlefshmëria e testamentit; nenin 378 të Kodit Civil lidhur me përjashtimin nga trashëgimia; nenin 332 të Kodit Civil lidhur me masën e pasurisë trashëgimore; nenet 761 e 762 të Kodit Civil lidhur me kontratën e dhurimit, kuptimi i saj dhe mund të ketë për objekt vetëm pasuritë e tashme të dhuruesit dhe se përfshirja e pasurive të ardhshme e bën dhurimin të pavlefshëm; neni 193/ç i Kodit Civil lidhur me detyrimin e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës të regjistrojë vendimin gjyqësor, si organ kompetent që mbikqyr dhe mban regjistrat e pasurive të paluajtshme; neni 200 i Kodit Civil lidhur me të drejtat e bashkëpronësisë në pjesë.
- *Pavlefshmëri titulli ekzekutiv*, gjyqtarja identifikon nenet 419 dhe 420 të Kodit Civil lidhur me kuptimin e detyrimit dhe përcaktimin se detyrimet lindin nga kontratat ose nga ligji; nenin 690 të Kodit Civil lidhur me fuqinë ligjore të kontratave për palët kontraktore; nenin 113 të Kodit Civil lidhur me paditë që nuk i nënshtrohen parashkrimit; nenin 131 të Kodit Civil lidhur me rastet e ndërprerjes së parashkrimit; nenin 61 të Kodit Civil të vitit 1981 lidhur me parashkrimin e së drejtës së kërkesës për ekzekutim të detyrueshëm të një vendimit të formës së prerë apo të një titulli ekzekutiv; neni 114 i Kodit Civil lidhur me afatin e përgjithshëm të parashkrimit; neni 125 i Kodit Civil lidhur me ngritjen e parashkrimit si një prapësim i palës së interesuar dhe jo kryesisht nga gjykata³².

Në Vendimin nr. 4858, datë 28.09.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt “Detyrimin e palës së paditur për të më shpërblyer për dëmin e plotë, pasuror dhe jopasuror si dhe shpenzimet e nevojshme dhe të arsyeshme të shkaktuara nga aksidenti i ndodhur në punë...”, gjyqtarja, krahas normave të Kodit Civil, identifikon edhe nenin nenin 289 të Kodit Penal, ku parashikohet figura e veprës penale të “Shkeljes së rregullave të mbrojtjes në punë“, në lidhje me Ligjin nr. 10237/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë“ mbi të cilin

³⁰ Vendimi nr. 4960, datë 03.10.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

³¹ Vendimi nr. 1170, datë 07.03.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

³² Vendimi nr. 6123, datë 21.11.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

ka nisur një hetim penal që ka përfunduar me pushimin e çështjes penal, por vendimi u bë pjesë e gjykimit civil.

Krahas dispozitave të Kodit Civil gjyqtarja referon në ligje të posaçme të cilat gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes dhe në një sërë dispozitash të Kushtetutës dhe akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës, duke identifikuar konkretisht:

- nenin 42/2 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, lidhur me të drejtën e çdo personi për një proces të rregullt ligjor³³;
- neni 12/1 i Kushtetutës lidhur me sigurimin e pavarësisë së vendit dhe mbrojtjes së tërësisë territoriale dhe rendit kushtetues të Republikës së Shqipërisë nga Forcat e Armatosura³⁴;
- ligjet nr. 33/2012 (neni 32) dhe nr. 7843/1994 (nenet 23, 28) lidhur me regjistrimet e pronave³⁵ ;
- ligjin nr. 8662/2000 lidhur me faturën tatimore të konsumit të të energjisë elektrike e cila përbën titull ekzekutiv; Ligjin nr. 8735/2001 lidhur me ngarkimin e zyrave të përmbartimit për ekzekutimin e faturave tatimore; VKM nr. 862/2006 “Për krijimin e shoqërisë “Operatori i sistemit të Shpërndarjes” Sha³⁶;
- nenet 2, 3, 4, 8 të ligji nr.8743/2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” dhe aktet nënligjore, të tilla si „VKM nr. 737/16.10.2012“, „VKM nr. 515/2003“ “VKM nr. 379/1995” për të përshkruar një fakt juridik civil, siç është kalimi nën administrim i njëres prej pronave objekt gjykimi në administrim të institucioneve të ndryshme siç është Ministria e Mbrojtjes. Këto akte nënligjore shënohen siç janë përcaktuar në këtë pikë, pa u shkruar i plotë data dhe titulli i Vendimit të Këshillit të Ministrave³⁷;
- Ligjin nr. 7698/1993, si një ligj që rivendoste një të drejtë të shkelur dhe jo një mënyrë e re e fitimit të pronësisë, qëllimi i të cilit ishte të rivendoste të drejtën e mohuar të pronarit të sendit të paluajtshëm nga shteti i kohës duke i njohur atij të drejtën e pronësisë dhe kthimin e pronës (apo në pamundësi kompesimin e saj); Ligjin nr. 8405/1998 “Për urbanistikën” i cili rregullon organet kompetente që japin leje ndërtimi, dokumentacioni i kërkuar, etj.; Ligjin nr. 8561/1999 “Mbi shpronësimin” në të cilin jepet kuptimi i shpronësimit (realizimi apo mbrojtje e interesave publikë“ duke ushtruar të drejta pronësie mbi pasuritë pronë private, objektet e shpronësimit dhe shkaku i shpronësimit në funksion të interesit publik (dhe ku mes të tjerave janë dhe ato për realizimin e projekteve dhe investimeve kombëtare apo vendore në funksion të arsimit publik) si dhe subjektet në favour të të cilit bëhet shpronësimi; Ligjet nr. 8562/2000, Ligji 69/2012, Ligji nr. 139/2015 mbi organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore, ku përcaktohet roli dhe detyrat e bashkive në lidhje me ndërtimin dhe rikonstruksionin e godinave të institucioneve arsimore publike; Ligjet 8743/2001, 8744/2001 për miratimin e listës së pjeshme të inventarit të pronave që janë në juridiksionin e Bashkisë Tiranë, për transferimin e pronave të paluajtshme publike shtetërore në njësitë e qeverisjes vendore³⁸;

³³ Vendimi nr. 479 datë 12.04.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

³⁴ Vendimi nr.2486, datë 09.05.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

³⁵ Vendimi nr. 4960, datë 03.10.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

³⁶ Vendimi nr. 6123, datë 21.11.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

³⁷ Vendimi nr.2486, datë 09.05.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

³⁸ Vendimi nr. 989, datë 28.02.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

- nenet 43, 46, 50 të Ligjit nr. 7703/1993) ku parashikohen të ardhurat që përfitohen për sigurimin nga aksidentet në punë ku mes të cilave dhe ato për paaftësi, kufiri për të përfituar nga KMCAP; nenin 22 të ligjit nr. 9634, datë 30.10.2006 ku parashikohet detyrimet e punëdhënësit të njoftojë Inspektoratin e punës për të gjitha aksidentet në punë) dhe VKM 788/2005 e cila përcakton se njoftimi i një aksidenti në punë duhet t'i bëhet Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore brenda tre ditëve nga punëdhënësi; nenet 10/b, 12/4, 40/1, 4, 5, 6, 7, 10, 12, 21,24, 25, 30 të ligjit nr. 10237/2010 lidhur me detyrimin e punëdhënësit për të hartuar dokument vlerësimi dhe parandalimi të rrezikut që përmban masat me karakter teknik që duhet të zbatohen³⁹.

Sa i përket konfliktit të normave, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtarja ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore procedurale ose materiale, referuar kjo edhe natyrës së çështjeve të trajtuara.

Gjyqtarja e ka vlerësuar aftësinë e saj për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave në shkallë shumë të lartë, duke u shprehur se: *“Në lidhje me aftësinë time profesionale për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave, e vlerësoj ‘Shumë e lartë’. Pas njohjes me çështjen konkrete/aktet e saj fokusohem në evidentimin e shkakut në përputhje kjo dhe me vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë/mbi shkakun e padisë/duke mundësuar kështu identifikimin e natyrës së vetë çështjes ,ligjit të zbatueshëm në rastin konkret pa u lidhur domosdoshmërisht me atë që përcaktojnë palët. Dëgjimi i palëve ndërgjyqësore, dhënia e mundësisë për tu shprehur brenda objektit të çështjes në kuadër të parimit të kontradiktoritetit, orientimi dhe kërkimi prej tyre që të japin shpjegime rreth natyrës së mosmarrëveshjes, pyetjet që iu drejtojnë mundësojnë në një identifikim të plotë të natyrës së çështjes dhe ligjit të zbatueshëm në funksion të plotë të dhënies së një vendimi të drejtë. Lidhur me konfliktin e normave bazohem në hierarkinë e tyre dhe në rregullimet ligjore të posaçme, trajtuar kjo dhe në vendime të Gjykatës Kushtetuese”*.

Lidhur me këtë tregues, në seancë plenare, në ndryshim me qëndrimin e mëparshëm të saj, gjyqtarja paraqiti kundërshtime, duke pretenduar se ka aftësi shumë të larta lidhur me këtë tregues, dhe se problematikat e konstatuara nga relatorja nuk çënojnë cilësinë e arsyetimit, pasi ligji nuk ka përcaktuar një strukturë të qartë të vendimit, si në lidhje me përshkrimin e rrethanave procedurale ashtu dhe me përshkrimin dhe analizën e rrethanave të faktit, të cilat janë analizuar tek pjesa e analizës. Në vendim janë përshkruar dhe analizuar ato rrethana procedurale që janë konsideruar të nevojshme si dhe faktet janë përshkruar dhe analizuar në pjesën e analizës juridike të vendimi.

KONKLUZIONI

³⁹ Vendimi nr. 4858, datë 28.09.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, Këshilli vlerësoj se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në paraqitjen dhe analizën e fakteve thelbësorë të çështjes të cilat në disa raste paraqiten në mënyrë të përmbledhur, duke i integruar në disa raste dhe provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre ndërsa në disa raste faktet e çështjes nuk janë përshkruar në pjesën e parë të pjesës arsyetuese- përshkuese, por janë përshkruar dhe analizuar tek pjesa e analizës juridike të vendimit. Në pjesën e analizës, gjyqtarja integron provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre. Ndërsa rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, si dhe në përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsyetimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e çështjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlersohet se aftësia e gjyqtarës në lidhje me treguesin “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktn e normave” është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 25 pikë.

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Interpretimi i ligjit është ekskluziviteti i gjyqtarës, interpretim i cili duhet të bëhet duke dhënë kuptimin e saktë dhe të rregullt normës ligjore. Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet ti japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*procedurale dhe materiale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi dhe duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore në shumicën e rasteve referohen ose citohen duke u shoqëruar në çdo rast me interpretimin e tyre abstrakt, si dhe i kushton rëndësi interpretimin me aplikimin mbi faktet e çështjes, si në ato me natyrë procedurale ashtu edhe në ato që kanë lidhje me themelin e çështjes. Gjyqtarja, në disa vendime burim vlerësimit, sidomos tek vendimet e zgjedhura prej tij, citimin ose referimin në dispozita e shoqëron me interpretimin të tyre në mënyrë të abstrakte, para aplikimit mbi faktin konkret ose konkluzionin e arritur. Nga burimet e vlerësimit konstatohet se përgjithësisht gjyqtarja përqendrohet në interpretimin e normës, të shoqëruar në disa raste edhe me praktikën e Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese apo të GJEDNJ, duke dhënë një panoramë të gjërë të praktikës lidhur me çështjet e ngjashme, duke e zbërthyer normën në raport me faktet e çështjes, për të shkuar si rrjedhojë logjike në konkluzionet e arritura lidhur me zbatimin e saj në rastet konkrete.

- *Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm:*

Në vendime përgjithësisht interpretimi i normës bëhet duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative ose alternative, që të gjejë zbatim norma konkrete dhe e analizon nomën në përputhje me faktin që ka rezultuar i provuar në gjykim. Në mënyrë më specifike, në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi rezulton se gjyqtarja analizon :

- nenin 23/3 të Kodit të Punës ku parashikohet se detyrimi i punëmarrësit të mos zbatojë urdhërat dhe udhëzimet e përgjithshme dhe të veçanta të punëdhënësit që rrezikojnë jetën dhe shëndetin e tij. Sipas Gjyqtares, ky nen përmban një të drejtë të punëmarrësit dhe jo një detyrim të tij që të trajtohet si shkak determinant në ardhjen e pasojës. Më tej, e aplikon këtë fakt mbi faktet e çështjes dhe konkloden se nuk kushtet kur edhe pse makineria ka pasur defekte teknike në vijëmbësi ajo ka vijuar punën, duhet të ishet punëdhënësi i saj ai që duhet të ndalonte përdorimin e makinerisë dhe të certifikonte rregullsinë e saj⁴⁰;
- nenet 86 e 87 të Kodit Civil të vitit 1981 në lidhje me nenet 1167 të Kodit Civil të vitit 1994 dhe neni 231 të Kodit të Familjes lidhur me rregullimin e bashkëpronësisë midis bashkëshortëve dhe prezumimin e barazisë së pjesëve për të vlerësuar nëse pasuritë objekt gjykimi bëjnë pjesë në bashkësinë ligjore dhe rrjedhimisht nëse janë pjesë e masës trashëgimore⁴¹ ;
- Interpreton teologjikisht dhe sistematikisht nenet 419, 476, 480, 690, 698 të Kodit Civil me nenet 32, 39 të Kodit të Punës për të konkluduar se Kodi i Punës parashikon të drejtën e palës kontraktore punëmarrëse që të dëmshpërblehet lidhur me aksidentet në punës, sipas parashikimeve në këto dispozita dhe në rast se cenohet në shëndetin e tij mendor dhe fizik⁴² ;
- Interpreton sistematikisht nenet 296, 297, 298 të Kodit Civil lidhur me padinë e *rivendikimit dhe të drejtat me natyrë personale që burojnë nga kjo padi*, si një padi të pronarit joposuedes ndaj poseduesit jopronar, ku kërkohet vërtetimi i dy kushteve: legjitimimi aktiv i palës paditëe (pronar i zhveshur tërësisht nga posedimi i sendit) dhe legjitimimi pasiv i palës së paditur (posedues i paligjshëm i sendit dhe që në momentin e ngritjes së padisë ka posedimin efektiv të sendit). Këtu trajton se padia e rivendikimit shoqërohet me kërkime të tjera si: shpërblim për përdorimin e tij dhe shpërblim për vlerën e sendit pronarit në pamundësi për të kthyer sendin, të cilat janë kërkime me natyrë personale/padi personale e detyrimi, por që vetë ligjvënësi i ka rregulluar me dispozita të së drejtës së pronës për shkak të koneksitetit të tyre, kjo në varësi të llojit të posedimit. Këtu, në interpretim gramatikor të neneve 304, 305, 306 të Kodit Civil trajton kuptimin e *posedimit dhe llojet e tij*, si i ligjshëm dhe i paligjshëm (në mirëbesim, në keqbesim⁴³;
- nenin 169 të Kodit Civil lidhur me institutin e parashkrimit fitues pa titull, duke përmendur kushtet që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative që të jemi para këtij instituti: posedimi i sendit, posedimi për një kohë të caktuar, sendi të jetë i aftë për t'u fituar me parashkrim fitues. Lidhur me posedimin, interpreton nenin 304 të Kodit Civil, ku thekson se posedimi duhet të jetë i pandërprerë, i qetë, publikë, dhe poseduesi të ketë vullnet t'a mbajë sendin si të vetin. Pas

⁴⁰ Vendimi nr. 4858, datë 28.09.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁴¹ Vendimi nr. 4960, datë 03.10.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁴² Vendimi nr. 4858, datë 28.09.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁴³ Vendimi nr. 989, datë 28.02.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

këtij interpretimi teorik, përjas rrethanat e faktit dhe konkludon lidhur me secilin element të posedimit dhe kusht të institutit të parashkrimit fitues⁴⁴;

- Interpreton nga ana historike institutit e parashkrimit fitues pa titull duke sjellë në vëmendje të lexuesit Dekretin nr. 2083, datë 06.07.1956 „Mbi pronësinë,, dhe nenet 91 e 92 të Kodit Civil të vitit 1982⁴⁵;
- nenin 463 të Kodit Civil lidhur me momentin që detyrimi bëhet i kërkueshëm në rastin konkret, ku del se detyrimi bëhet i kërkueshëm nga data 2 e muajit pasardhës deri në fund të tij, pra është detyrim periodik dhe bëhet i kërkueshëm me mbarimin e muajit pasardhës⁴⁶;
- nenin 112 të Kodit Civil lidhur me kuptimin e parashkrimit sipas të cilit është fakt juridik që sjell shuarjen e së drejtës subjektive, atë të padisë dhe të kërkimit të ekzekutimit të titullit kur plotësohen dy kushte: mosveprimi i titullarit të së drejtës dhe kalimi i afatit të caktuar me ligj⁴⁷;
- interpreton nga ana historike institutit e parashkrimit të së drejtës së kërkesës për ekzekutim të detyrueshëm të një vendimit të formës së prerë apo të një titulli ekzekutiv, duke cituar nenin 61 të Kodit Civil të vitit 1981⁴⁸;
- interpreton nga ana sistematike nenet 112, 114 të Kodit Civil lidhur me mosparashikimin nga ligji të afateve të parashkrimit të kërkesave për vënien në ekzekutim dhe afati i përgjithshëm të parashkrimit, duke arritur në konkluzionin se afati i parashkrimit do të jetë afati i parashkrimit të padive me të cilat janë të lidhur titujt ekzekutiv, për të cilën kërkohet ekzekutimi⁴⁹;
- nenin 349 të Kodit Civil lidhur me padinë e kërkimit të trashëgimit/pasurisë trashëgimore, për të cilën shprehet se që të mund të ngrihet kjo padi, pala paditëse duhet të provojë: i) legjitimitimin aktiv, pra qenien e saj trashëgimtare; ii) legjitimitimin pasiv, pra pala e paditur i mohon cilësinë si trashëgimtare dhe pretendon për vete se është trashëgimtare duke e mbajtur pa titull ose me titull trashëgimtari dhe jo kur e mban me një titull tjetër⁵⁰ ;
- nenin 41 të Kushtetutës lidhur me të drejtën e pronës private, prej të cilës buron neni 163 i Kodit Civil, i cili përcakton mënyrat e fitimit të pronësisë, dhe në lidhje me to përmend disa lloje padish të pronarit që mbron të drejtën e tij të pronësisë si një të drejtë absolute, të lidhur dhe ndërvarur me rrethanat e çështjes, të tilla si: neni 296 të Kodit Civil lidhur me padinë për kërkimin e sendit; neni 349 e vijues i Kodit Civil lidhur me padinë trashëgimore; neni 612 i Kodit të Procedurës Civile lidhur me padinë e pronarit në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm⁵¹;
- nenet 349 -350 të Kodit Civil lidhur me padinë e trashëgimit, si një mjet mbrojtje të të gjitha të dretjave të pasurisë trashëgimore, padi reale që lidhet me të drejtën e pronësisë, dhe kushtet ligjore të ngritjes së saj janë: qenia trashëgimtar (ligjor, testamentar); kërkimi i pasurisë trashëgimore; qenia e poseduesit trashëgimtar ose jo i pasurisë trashëgimore. Kjo padi ka karakter universal të përgjithshëm, për të gjithë sendet dhe të drejtat që rrjedhin nga trashëgimia; ka karakter të përzier sepse ngrihet ndaj kujtdo si padi reale, edhe ndaj atij që pretendon se është trashëgimtar; ka karakter personal, mund të ngrihet pas vdekjes së trashëgimtarit, dhe ka si qëllim: ti njihet e drejta trashëgimore dhe ti dorëzohet pasuria

⁴⁴ Vendimi nr.2486, datë 09.05.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁴⁵ Vendimi nr.2486, datë 09.05.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁴⁶ Vendimi nr. 6123, datë 21.11.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁴⁷ Vendimi nr. 6123, datë 21.11.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁴⁸ Vendimi nr. 6123, datë 21.11.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁴⁹ Vendimi nr. 6123, datë 21.11.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁵⁰ Vendimi nr. 4960, datë 03.10.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁵¹ Vendimi nr. 4960, datë 03.10.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

- trashëgimore dhe pasuria e fituar prej saj. Padiës paraqitet trashëgimtari dhe të paditur personi që e posedon duke e konsideruar veten trashgimtar, ose trashgimtarët e tjerë;
- interpreton në mënyrë sistematike nenet 377, 360, 361, 362, 363, 364 të Kodit Civil, aplikon këto dispozita mbi rrethanat e rastit konkret dhe vëren se testatori ka disponuar në favor të një personi (të paditur) që nuk bën pjesë në rrethin e trashëgimtarëve ligjor dhe kështu jemi përpara pavlefshmërisë së testamentit, sepse testatori ka pasur trashëgimtar nga radhët e trashgimisë ligjore nipërit e tij (fëmijët e fëmijëve)⁵²;
 - interpreton në mënyrë teologjike nenin 378 të Kodit Civil me dispozitat e tjera mbi testamentin, lidhur me përjashtimin nga trashëgimia dhe sqaron se pranohen dy lloje përjashtimi nga trashëgimia me anë të testamentit: i) përjashtimi nga trashëgimia ligjore të një/disat trashëgimtarëve pa caktuar trashgimtar (përjashtim i shprehur); ii) përjashtim duke caktuar trashgimtar në testament (përjashtim i heshtur). Sipas Gjyqtares, neni 378 i Kodit Civil rregullon përjashtimin e shprehur⁵³;
 - nenet 761 dhe 762 të Kodit Civil lidhur me kontratën e dhurimit dhe aplikon në rrethanat e rastit, me qëllim verifikimin nëse sendi objekt gjykimi dhe objekt dhurimi në kontratën paraprake të dhurimit, përbën ose jo pjesë të masës trashgimore. Gjyqtarja vlerëson se dhurimi nuk mund të jetë për një send të ardhshëm, ndaj sendi që pretendon I padituri se e ka përfutur me dhurim, bën pjesë në masën e pasurisë trashgimore⁵⁴.

Përsa i përket interpretimit të dispozitave procedurale civile dhe penale, gjyqtarja i jep rëndësi interpretimit të normës së zbatueshme si në rastet kur trajtohen çështje të procedurës, ashtu edhe në rastet kur është vetë dispozita procedurale ajo që vjen në ndihmë të zgjidhjes së çështjes në themel, si p.sh çështjet penale të seancës paraprake. Konkretisht analizon:

- nenin 578 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me padinë për veçimin e pjesës takuese të debitorit bashkëpronar mbi sendin që do të bëhet ekzekutimi, për të cilin sqaron se ky nen përmban rregullim të shprehur mbi mënyrën e ekzekutimit të detyrimit të debitorit mbi një send në bashkëpronësi të tij me të tretë dhe ku pas sekuestrimit bëhet veçimi i pjesës takuese të debitorit bashkëpronar dhe vetëm mbi këtë pjesë bëhet ekzekutimi⁵⁵;
- nenet 608, 609, 610, 612 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me paditë mbrojtëse gjatë fazës së ekzekutimit të tilla si pavlefshmëria e titullit ekzekutiv, kundërshtimi i veprimeve përbarimore dhe padia e pronarit të sendit gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm. Gjyqtarja trajton veçanërisht nenin 612 të Kodit të Procedurës Civile, si një kërkim të personit të tretë jo palë në një procedurë ekzekutimi, që pretendon të drejta pronësie mbi këtë send, duke sqaruar se kjo padi nuk mund të ngrihet nëse ka përfunduar procedura e ekzekutimit⁵⁶;
- nenin 614 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me mënyrën e trajtimit të sendit të paluajtshtëm të shitur në ankand, kur bëhet njohja juridike e së drejtës së pronësisë së paditësit pronar ndaj blerësit të sendit apo kreditorit të procedurës së kredisë dhe kthimin e pronës tek pronari real i saj⁵⁷;

⁵² Vendimi nr. 1170, datë 07.03.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁵³ Vendimi nr. 1170, datë 07.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁵⁴ Vendimi nr. 1170, datë 07.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁵⁵ Vendimi nr. 4960, datë 03.10.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁵⁶ Vendimi nr. 4960, datë 03.10.2022, Vendimi nr. 4858, datë 28.09.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁵⁷ Vendimi nr. 4960, datë 03.10.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

- nenin 580 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me kundërshtimin e pronësisë së sendit të shitur në ankand e të veprimeve të përmbauesit gjyqësor që ti japë mundësinë të tretit të kërkojë sendin e tij me padi edhe pas shitjes⁵⁸;
- nenin 72 pikat 1-6 të K.Pr.Civile si shkaqe përjashtimi objektive dhe nenin 72 pika 6 si shkak subjektiv të përjashtimit të gjyqtarit. Gjyqtarja arrin në përfundimin se fakti se djali i gjyqtarit është përfaqësues i një pale në një gjykim tjetër kundër palës së paditur nuk përbën apriori shkak për përjashtimin e gjyqtarit⁵⁹;
- nenin 70 të Kodit të Procedurës Penale mbi rrethanat e çështjes lidhur me efektet e një vendimi penal për gjykimin civil ku shqyrtohen pasojat e veprës, si i detyrueshëm vetëm sa i përket faktit nëse vepra është kryer dhe nëse është kryer nga i gjykuari⁶⁰.

Në lidhje me aftësinë për të përdorur jurisprudencën relevante, rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përdorur gjerësisht jurisprudencën relevante (*vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e Kolegjit Civil dhe Penal të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ*), në mbështetje të argumenteve të saj në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, kryesisht në rastet si më poshtë:

- Referon Vendimin Unifikues nr. 12/2007 dhe 14/2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, lidhur me shpërblimin e dëmit pasuror dhe jopasuror, vendim që pati si qëllim interpretimin e dispozitave të përgjithshme të shpërblimit të dëmit, duke u interpretuar gjerësisht parimet mbi shpërblimin e dëmit, llojet e tij, figurat e veçanta (biologjik, moral, ekzistencial), etj., por edhe përlllogaritja u referua që të kryhej në bazë të akteve nënligjore të posaçme të dala për këtë qëllim (nëse ka) dhe në mungesë të tyre, duke konsideruar metodologji të tjera të njohura për këtë qëllim, pasi të ketë marrë mendimin e ekspertit mjekoligjor dhe atij financiar⁶¹;
- Referon Vendimin nr. 205, datë 04.04.2017 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë lidhur me institutin e shpronësimit de facto si një nga format e ndërhyrjes së shtetit për interesa publik në pronën private si dhe Vendimin Unifikues nr. 1 datë 06.01.2009 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë lidhur me efektet e regjistrimit në regjistrat e pasurive të paluajtshme, i cili nuk të bën pronar, por ka efekt deklarativ⁶²;
- Referon Vendim nr. 379, datë 12.10.2010 të Gjykatës së Lartë lidhur me elementët thelbësor të parashkrimit fitues pa titull si dhe Vendimin nr. 4, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese lidhur me posedimin e qetë dhe pa ndërprerje të parashkrimit fitues⁶³;
- Referon Vendimin Unifikues nr. 3, datë 29.03.2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë lidhur me përcaktimin e llojit të padisë dhe shkakut të saj si dhe Vendimin nr. 86/2014 të Gjykatës së Lartë lidhur me ngritjen e padisë sipas nenit 612 të K.Pr.Civile vetëm gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm, kur përmbauesi gjyqësor ka përfshirë pasurinë e pretenduar nga personi i tretë paditës në rrethin e sendeve që do i nënshtrohen sekuestrimit dhe më pas shitjes

⁵⁸ Vendimi nr. 4960, datë 03.10.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁵⁹ Vendimi nr. 479 datë 12.04.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁶⁰ Vendimi nr. 4858, datë 28.09.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁶¹ Vendimi nr. 4858, datë 28.09.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁶² Vendimi nr. 989, datë 28.02.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁶³ Vendimi nr.2486, datë 09.05.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

- nëpërmjet ankandit. Gjithashtu gjyqtarja referon Vendimin Unifikues nr. 1/2009 të Gjykatës së Lartë lidhur me efektet e regjistrimit të pronësisë në regjistër dhe titulli i pronësisë⁶⁴ ;
- Referon Vendimin Unifikues nr. 3, datë 29.03.2012 të Gjykatës së Lartë lidhur me identifikon e shkakut ligjor të padisë, arsytet e kërimit gjyqësor, i cili ndahet në të drejtën dhe në një gjendje fakti që është kundër kësaj të drejte, që e shkel, e cenon apo e mohon të drejtën subjektive të paditësit; Vendimin nr. 49, datë 07.06.2018 të Gjykatës së Lartë lidhur me interpretimin e neneve 377, 374 të Kodit Civil dhe në këtë vendim mbahet qëndrimi që vullneti i trashëgimlënësit duhet të jetë në përputhje me ligjin si dhe Vendimin Unifikues nr. 1/2005 të Gjykatës së Lartë lidhur me trashëgimin universal dhe atë me titull universal, masën trashgimore⁶⁵ .

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, nga tërësia e vendimeve burim vlerësimi, rezulton kujdesi i gjyqtarës që gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes të referohen dhe zbatohen parimet e përgjithshme të së drejtës, gjë që realizohet duke i përmendur ato shprehimisht apo të nxjerra nga konteksti i arsytimit të vendimit. Gjyqtarja njih, referon dhe zbaton parimet materiale dhe procedurale gjatë gjykimit, siç janë:

- Parimin e paanësisë së gjykatës në procesin gjyqësor si element i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor duke cituar përmbajtjen e nenit 42/2 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, lidhur me të drejtën e çdo personi për një proces të rregullt ligjor⁶⁶ .

Gjyqtarja e ka vlerësuar aftësinë e saj për të për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes në shkallë shumë të lartë, duke u shprehur se: *“Në lidhje me aftësinë për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes në kontekstin e sa më sipër çmoj se kam aftësi ‘Shumë të Lartë’/ dhe kjo si rezultat i një pune vijuese në njohjen sa më thellë të ligjit, të interpretimit të tij në kontekstin e rastit konkret në shqyrtim, në njohjen me vendimet unifikuese/apo njehsuese dhe praktikën brenda dhe jashtë vendit (GJEDNJ). Duhet theksuar se referimi i jurisprudencës në vendime është bërë në rastet kur kjo ka qenë e rëndësishme, në funksion (si burim i të drejtës apo në shërbim të interpretimit të ligjit) të zgjidhjes së çështjes dhe jo thjesht për të pasur në vendim një referencë të tillë”*.

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka shfaqur aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen, interpretim që bëhet si në aspektin abstrak ashtu edhe në raport me faktet e çështjes dhe kur është e nevojshme, në mbështetje të arsytimit të vendimeve, identifikon dhe zbaton praktikën gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, si dhe zbaton dhe respekton parimet e së drejtës. Interpretimi i ligjit bëhet në funksion të konkluzioneve mbi zgjidhjen e çështjeve konkrete.

⁶⁴ Vendimi nr. 4960, datë 03.10.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁶⁵ Vendimi nr. 1170, datë 07.03.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁶⁶ Vendimi nr. 479 datë 12.04.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.

1.B ARSYETIMI LIGJOR

1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballet gjyqtarja, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitivin e vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar. GJEDNJ është shprehur se, megjithëse gjykatave i lejohet një liri e konsiderueshme veprimi, përsa i përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për tu ankuar⁶⁷.

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtarja gjatë gjykimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuara, në komunikimin shkresor me të tretët dhe vendimet përfundimtare është përgjithësisht e qartë dhe e kuptueshme për pjesëmarrësit në proces, si dhe për lexuesin.

Termet teknikë janë përdorur në mënyrë korrekte dhe vetëm në rastet kur përdorimi i tyre është i pashmangshëm, duke iu referuar ligjeve dhe akteve nënligjore të posaçme që zbatohen mbi marrëdhënien objekt gjykimi.

Në referimin e instituteve dhe parimeve të së drejtës gjyqtarja i përmend ato në arsyetim duke i cituar në gjuhën shqipe, pa krijuar konfuzion për kuptimin e tyre për lexuesin. Nuk evidentohet përdorim i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyes apo denigrues.

Gjyqtarja përgjithësisht përdor të gjitha shkronjat e gjuhës shqipe (përveç shkronjës “ç” dhe ndonjëherë shkronjës “ë”, të cilën jo gjithmonë e përdor). Në vendimet burim vlerësimi, konstatohet se jo gjithmonë gjyqtarja përdor rregullat gramatikore në drejtshkrimin e saktë të fjalëve dhe në ndërtimin e saktë të fjalive, kryesisht në ndërtimin e fjalive, në mospërdorimin e rregullt të shkronjave të mëdha në fillim të fjalisë, në përdorimin e pasaktë të shenjave të

⁶⁷ Vendimi i GJEDNJ, Çështja Dadjanastassion vs Greqisë, datë 16.12.1992, faqe 33.

pikësimi dhe fillimit të fjalisë në kryeradhën etj. Konstatohet se pjesa arsyetuese përshkruese fillon gjithmonë me shkronjë të vogël dhe kjo karakteristikë e gjyqtarës shikohet në disa raste edhe në vijim të pjesën përshkruese- analizuese.

Gjyqtarja përdor fjali me gjatësi mesatare, ndonjëherë të gjata, duke shprehur mendimin përgjithësisht në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme dhe duke organizuar fjalitë në rrjedhë logjike me njëra-tjetrën, por që ndonjëherë qartësia dhe rrjedha e mendimit humbet nga fakti i mosndërtimit të saktë të fjalive, përsëritja dhe nga mungesa e paragrafëve të mirëdallueshëm. Kjo mënyra e organizimit dhe shprehjes së mendimit në arsyetimin e vendimeve e vështirëson disi rrjedhshmërinë e vendimit, duke humbur në disa raste filli logjik.

Në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë së vendimit, veç pjesës hyrëse dhe përshkruese-arsyetuese të vendimit, evidentohet se në dispozitivin e vendimit gjyqtarja përgjithësisht shprehet në mënyrë të plotë dhe koncize për të gjitha kërkimet e objekti të padisë në rastet e pranimit të saj, për faktin se vendimi është i zbatueshëm nga shërbimi përmbartimor, shpenzimet gjyqësore, të drejtën e ankimit, afatin e ankimit dhe momentin e fillimit të tij.

Por në lidhje me shpenzimet gjyqësor konstatohet se disponimi i gjykatës jo gjithmonë është i qartë dhe i plotë, pasi në rastin kur gjykata ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë, nuk ka përcaktuar masën apo raportin e shpenzimeve që i ngarkohen palës konkret ndaj të cilës gjykata ka disponuar⁶⁸. Përcaktimi i saktë i shpenzimeve gjyqësore është pjesë tepër e rëndësishme e vendimit, pasi lidhet me fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor dhe përcaktimi i saktë i shpenzimeve që i ngarkohen njërës palë është detyrë e gjykatës dhe jo e përmbartuesit gjyqësor.

Në drejtim të komponentit të “koncizitetit”, konstatohet lehtësisht në mënyrën e të shkruarit të gjyqtarës, zgjatja e mendimit tek pasqyrimi i pretendimeve të palëve, të cilat në disa raste nuk paraqiten në mënyrë të përmledhur, por paraqiten në mënyrë të detajuar, duke referuar kështu si dispozitat ligjore por dhe qëndrimet e mbajtura nga Gjykatat më të Larta lidhur me çështjen konkret⁶⁹. Kujdesi që gjyqtarja tregon në pasqyrimin e të gjitha pretendimeve të palëve mbingarkon pjesën përshkruese të vendimit, me përsëritje faktesh si dhe në prova të cilat më pas analizohen tek pjesa e analizës ligjore apo përsëritje të dispozitave ligjore dhe të qëndrimeve të Gjykatës së Lartë. E njëjta karakteristikë e gjyqtarës konstatohet edhe në paraqitjen e qëndrimeve të Gjykatës së Lartë të mbajtur në vendimet unifikuese, ku konstatohet se në vendimin gjyqësor pasqyrohet një pjesë e konsiderueshme e arsyetimit të Gjykatës së Lartë (në më shumë se dy faqe)⁷⁰ apo rikthim në këto qëndrime, në vijim të analizës së kërkimeve të palëve. Gjyqtari duhet të tregojë aftësi në paraqitjen e përmbledhur të pretendimeve të palëve sepse gjithpërfshirja dhe saktësia e paraqitjes së çdo pretendimi nuk nënkupton ricitim në vendim të gjithë apo një pjesë të konsiderueshme të përmbajtjes së pretendimeve të palëve. Gjithashtu, citimi i një pjesë të gjërë të përmbajtjes së vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë, duke sjellë në disa raste edhe përsëritjen e këtyre qëndrime

⁶⁸ Vendimi nr.1170, datë 07.03.2022, vendimi nr.6123, datë 21.11.2022, vendimi nr.4858, datë 28.09.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁶⁹ Vendimi nr.4960, datë 03.10.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁷⁰Vendimi nr.4960, datë 03.10.2022, vendimi 4858, datë 28.09.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

në një vendim, mbingarkon së tepërmi vendimin, duke e bërë atë të vështirë të kuptohet nga personat që i drejtohet pasi jo të gjithë kanë njohuri të posaçme për ligjin.

Edhe për këtë tregues, gjyqtarja paraqiti kundërshtime, duke pretenduar se vendimet e saj janë të qarta dhe se nuk mendon se shfaqen problematika lidhur me ndërtimin e saktë të fjalive, zbatimin e rregullave gramatikore etj. Do të tërhiqej nga ky mendim vetëm në rast se vendimet e saj do ishin vlerësuar nga një ekspert i gjuhës. Gjithashtu, nuk mendon se përshkrimi i detajuar i pretendimeve të palëve, apo citimi i gjërë i përmbajtjes së vendimeve unifikuese, mbingarkon së tepërmi vendimin, duke e bërë atë të vështirë të kuptohet nga personat që i drejtohet pasi jo të gjithë kanë njohuri të posaçme për ligjin. Ajo ka referuar këto qëndrime për të qenë më të qartë dhe shpesh herë përsëritja e këtyre qëndrimeve në vendim, ka ardhur për shkak të dhënies përgjigje të argumentuar të të gjitha pretendimeve të palëve.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, Këshilli vlerësoi se gjyqtarja përgjithësisht i kushton rëndësi të posaçme arsytimit të vendimeve në drejtim të kuptueshmërisë për lexuesin. E njëjta rëndësi evidentohet në drejtim të koncizitetit të pjesës përshkruese- arsyetuese, tek nënndarja e pretendimeve të palëve apo tek pjesa e analizës ligjore, ku konstatohet se disa pjesë të tij përsëriten fakte, dispozita ligjore si qëndrime të Gjykatës së Lartë. Paraqitja ndonjëherë e përmbledhur e pretendimeve të palëve, dhe ndonjëherë në mënyrë të detajuar apo tendenca për të pasqyruar një pjesë të konsiderueshme të qëndrimit të Gjykatës së Lartë, duke sjellë edhe përsëritje të herë pas hershme të tyre, e bën të qartë vendimin për një person të zakonshëm (jo jurist).

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 9 pikë.

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit.

Organizimi i arsytimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj do ta kuptojë dhe të bindet nga argumentet e përdorura nga gjyqtarja. Nëse gjyqtarja në dhënien e argumenteve ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kyçe të vendimit mund të humbasin, apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsytimi të ndjekë një format të qartë organizimi, në funksion të orientimit të lexuesit dhe të kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor. Edhe pse nuk ka një unifikim në lidhje me mënyrën e strukturimit të një vendimi gjyqësor, e për pasojë i jep një liri gjyqtarës në strukturimin e tij, nga ana tjetër, referuar rregullave të shkrimit dhe arsytimit ligjore,

shkrimi ligjor ka strukturën e tij specifike, që juristët/ gjyqtarët duhet ta përdorin në një formë apo në një tjetër, dhe pavarësisht nëse ndiqet metoda IRAC (*Issue, Rule, Application, Conclusion*), CRAC (*Conclusion, Rule, Application, Conclusion*) etj, të gjitha këto metoda duhet të jenë në funksion të argumentimit ligjor të përdorur nga gjyqtarja në zgjidhjen e çështjes, duke shtruar çështjen/ pyetjen për zgjidhje, normën relevante që duhet të zbatohet për zgjidhjen e saj, analizën e fakteve përkatëse në lidhje me çështjen e shtruar për zgjidhje dhe konkluzionin e arritur.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

Gjyqtarja në hartimin e vendimit përgjithësisht ndjek një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar, të cilës i përmbahet kryesisht me përshkrimin e pretendimeve të palëve, në disa raste me prezantimin e disa fakteve në lidhje me themelin e çështjes (jo atyre me natyrë procedurale), identifikimit të ligjit të zbatueshëm, argumentimin ligjor dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Megjithëse konstatohet se gjyqtarja ndjek përgjithësisht një metodologji strukturimi të pjesëve përbërëse të vendimit edhe pse jo në aspektin formal të saj, nuk konstatohet e njëjta metodologji strukturimi tek secili vendim. Në disa vendime burim vlerësimi mungon pasqyrimi i rrethanave të faktin (sikurse jemi shprehur në treguesin 1.A.a) siç kanë rezultuar gjatë gjykimit, të cilat më pas përshkruhen dhe analizohen tek pjesa e analizës apo argumentit logjik mbi faktet e çështjes dhe pretendimet e palëve, duke filluar arsyetimin direkt me pasqyrimin e pretendimeve të palëve, apo dhe me citimin e provave të paraqitura prej palës paditëse, për të vijuar me arsyetimin e saj mbi bazueshmërinë e këtyre pretendimeve në prova dhe në ligj.

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim: të dhënat e regjistrimit dhe gjykata që ka gjykuar çështjen; trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore; data e shqyrtimit; palët duke përcaktuar aktet e përfaqësimit në të gjitha ekstremitetet e tyre, objekti i shqyrtimit dhe baza ligjore; kërkimet përfundimtare të palëve.

Pjesa përshkuese-arsyetuese e vendimit organizohet në një strukturë të qëndrueshme dhe unike, por jo gjithmonë e ndarë në paragrafë sipas një rrjedhe logjike apo e ndarë në pjesë apo nënpjesë me tituj apo me fjali hyrëse përshkuese. Mënyra e organizimit të pjesës përshkuese-arsyetuese të vendimeve burim vlerësimin ndjek përgjithësisht këtë renditje:

- (i) *prezantimi e çështjes* ku përgjithësisht e cilëson që jemi përpara një çështje civile dhe prezantimin e padisë me të cilën paditësi i është drejtuar gjykatës. Gjyqtarja përgjithësisht nuk bën një prezantim të ecurisë procedurale të çështjes, nuk evidentohen kërkesat e parashtruar nga palët gjatë gjykimit si dhe vendimmarrjet e ndërmjetme të gjykatës gjatë procesit si p.sh. në rastin e shqyrtimit të kërkesës për sigurimin e padisë⁷¹, pranimin për ndryshimin apo shtimin e objektit të padisë, apo pushimin e gjykimit për disa nga kërkimet për shkak të heqjes dorë nga pala paditëse, etj, të cilat në disa raste janë të nevojshme të përshkruhen dhe arsyetohen në shërbim të qartësisë së vendimit si për palët pjesmarrëse

⁷¹ Vendimi nr. 4960, datë 03.10.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

në gjykim ashtu dhe për gjykatat më të larta, në rastet kur do të shqyrtohet çështja për shkak të ankimit. Ndërsa në disa raste konstatohet përshkrimi i disa nga elementëve procedural, të cilat nuk merren në analizë nga gjykata, por vetëm citohen.

- (ii) *Rrethanat e faktit*. Rezulton që prezantimi i faktit në disa vendime është paraqitur në pjesën e parë të vendimit, ku në disa raste referohen dhe provat e administruara dhe të marra në shqyrtim megjithëse jo të plota, rrethana që më pas përshkruhen dhe analizohen tek pjesa e vlerësimit të gjykatës. Ndërsa në disa vendime, në këtë pjesë të vendimit, gjyqtarja nuk bën një prezantim të përmbledhur të rrethanave dhe provave të marrë në shqyrtim, duke filluar arsyetimin me paraqitjen e pretendimeve të palëve, që në disa raste paraqiten në mënyrë të detajuar, kërkimet e tyre në raport me faktet e çështjes dhe se si gjen zbatim ligji në rastin konkret, për të vijuar më pas me analizën ligjore të çështjes në raport me rrethanat e çështjes dhe provave të marra në shqyrtim.
- (iii) *Pretendimet e palëve*. Në të gjitha vendimet burim vlerësimi gjejnë pasqyrim pretendimet e palëve, provat e referuara nga ana e tyre, si dhe referencat ligjore mbi të cilat mbështeten pretendimet e tyre, të cilat në disa raste paraqiten në mënyrë të përmbledhur dhe në disa raste në mënyrë më të detajuara.
- (iv) *Vlerësimi i gjykatës lidhur me çështjen (edhe pse në vendime nuk gjendet me këtë titull)*. Pas evidentimit të fakteve të çështjes, në ato raste kur ato evidentohen qartë, si dhe përshkrimi të pretendimeve të palëve, arsyetimi vijon me analizën mbi faktet konkrete, duke e gërshetuar arsyetimin me referimin në ligjin procedural dhe material të zbatueshëm, zbrëthimin dhe analizën e tij, duke evidentuar kushtet e nevojshme që duhet të plotësohen në rastin konkrete dhe përjasjen e tij me faktet e provuar në gjykim, për të vijuar me konkluzionin lidhur me bazueshmërinë ose jo në ligj të padisë. Pjesë e analizës ligjore, janë edhe pretendimet e palëve të cilat merren në analizë lidhur me ligjin dhe me faktet e provuara. Në përfundim të analizës ligjore në tërësi, ose në lidhje me secilën çështje të shtruar për vlerësim apo kërkesë të objektit të padisë, gjyqtarja konkludon lidhur me çështjen, duke e paraqitur këtë pjesë, si sintezë të analizës ligjore të kryer.

Në pjesën e dispozitivit, gjen pasqyrim disponimi i gjykatës në lidhje me pranimin/ rrëzimin e padisë, përcaktimin e detyrimeve të palës së paditur, në rastet kur padia është pranuar tërësisht ose pjesërisht, përcaktimi i cilësisë së vendimit si titull ekzekutiv, disponimin për shpenzimet gjyqësore, të cilat siç u tha në treguesin "*I.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit*" nuk janë gjithmonë të qarta, dhe të drejtën e ankimit.

Gjyqtarja e ka vlerësuar aftësinë e e ka vlerësuar aftësinë e tij për të hartuar vendimin sipas një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar në shkallë shumë të lartë, duke u shprehur se: "*Në lidhje me strukturën e vendimit gjyqësor shprehem që kam aftësi 'Shumë e lartë' dhe kjo bazuar në elementë të tillë, si: strukturë e qartë e vendimit, vijë logjike e mirëstrukturuar, ku në pjesën arsyetuese të tij jepen rrethanat e faktit, pretendimet e palëve, analiza e gjykatës, referimet e duhura ligjore gjithmonë në funksion të asaj që është trajtuar në vendim, analiza/trajtimi i të gjithë pretendimeve të palëve dhe zgjidhja e tyre, analiza e provave dhe vlera e tyre; vendimi është i strukturuar në paragrafë të cilët ndjekin një vijë logjike-në funksion të trajtimit dhe zgjidhjes së çështjes deri në arritjen e konkluzionit përfundimtar të gjykatës nisur kjo nga qëllimi për orientimin e lexuesit dhe kuptueshmërinë e*

përmbajtjes së tij. Duhet theksuar se në lidhje me strukturën e vendimit nuk kemi një unifikim të saj (unifikim të mënyrës së strukturimit të vendimit gjyqësor) dhe në këtë kontekst kemi lirinë e gjyqtarit, por e parë kjo ngushtë me shtruarjen e çështjes/ve për zgjidhje ,normën relevante që duhet të zbatohet, analizën e fakteve dhe konkluzionin e arritur. Struktura e përdorur nga ana ime konsiderohet si një strukturë e plotë, e mirëorganizuar, e cila është gjithëpërfshirëse ku pasqyrohen qartë marrëdhënia juridike objekt i konfliktit, rrethanat e faktit, pretendimet e palëve dhe zgjidhja që gjykata iu jep atyre duke kaluar rrjedhshëm deri në konkluzionet përmblylëse që determinojnë zgjidhjen e çështjes gjyqësore. Në këtë strukturë nuk ka një nëndarje të tillë ,të titulluar ‘ligji i zbatueshëm’ dhe ku të jenë pasqyruar/cituar të gjithë dispozitat ligjore përkatëse procedurale dhe materiale/pasi çmoj se kjo nuk e ndihmon lexuesin-përdoruesin e këtij vendimi. Në vendimet e mia ligji/dispozitat në pikëpamje materiale janë vendosur në lidhje të ngushtë me faktin e trajtuar dhe analizuar; ndërsa dispozitat procedurale në analizë të provave apo veprimeve procedurale gjatë gjykimit. Dispozitat harmonizohen me trajtimin e provës, faktit, pretendimit duke bërë që të kemi një individualizim më të plotë, me të ndërthurur dhe qartësi në konkluzion”.

Edhe për këtë tregues, gjyqtarja paraqiti kundërshtime, duke pretenduar se nuk ka një strukturë të përcaktuar të vendimit, në mënyrë që gjyqtarja ta zbatojë e për këto arsye ajo ka qenë e lirë të zgjedh një strukturë të caktuar. Gjithashtu, ajo pretendoi se për shkak të mungesës së përshkrimit dhe analizës së rrethanave të faktit është penalizuar edhe për këtë tregues, që e konsideron të padrejtë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, Këshilli vlerësoi se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të organizuar të vendimit. Gjyqtarja ndjek përgjithësisht një strukturë sipas këtij rendi: parashtrimi i rrethanave të faktit (në disa raste dhe jo gjithmonë paraqitet i plotë), pretendimet e palëve, analizimin e fakteve dhe të provave të paraqitura, duke e integruar me ligjin e zbatueshëm që duhet të shqyrtohen nga gjykata në lidhje me themelin, duke përfshirë analizën e pretendimeve të palëve dhe në fund të pjesës arsyetuese ose të çdo pjesë të veçantë të tij, përfundimet e arritura nga gjykata, ndërsa në disa vendime strukturimi nuk bëhet sipas këtij rendi logjik. Përgjithësisht konstatohet se gjyqtarja strukturon qartë mendimin dhe argumentimin logjik, në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit. E njëjta aftësi konstatohet edhe në përshkrimin dhe analizën e fakteve procedurale dhe në paraqitjen e ecursisë procedurale të çështjes, e cila në disa raste është e nevojshme dhe në përshkrimin dhe analizën e fakteve thelbësore të çështjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se aftësia e gjyqtarës në treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit”, është “Mbi mesatare” dhe pikëzohet me 8 pikë.

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballet gjyqtarja, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitivin e vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar. GJEDNJ është shprehur se, megjithëse gjykatave i lejohet një liri e konsiderueshme veprimi, përsa i përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për tu ankuar⁷².

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

Në vendimet e analizuara, përgjithësisht rezulton një nivel shumë i mirë arsyetimi, gjithnjë i plotë dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të diskutueshëm në raport me faktin civil, si dhe çdo element të vlerësuar nga gjyqtarja si të nevojshëm për t’u analizuar në raport me aspektet procedurale. Arsyetimi i vendimeve përfundimtare ndjek një organizim dhe një zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material civil, duke u kujdesur, për të identifikuar dhe analizuar koncepte ligjore specifike, në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me zgjidhjen e çështjes.

Arsyetimi i vendimeve përfundimtare, pas përcaktimit të fakteve të çështjes, të cilat në disa raste paraqiten në mënyrë të saktë, zhvillohet mbi bazën e një procesi analitik dhe vlerësuese të fakteve dhe provave në raport me njëra tjetrën, si dhe ligjin e zbatueshëm. Konstatohet se gjyqtarja i kushton rëndësi identifikimit dhe analizës së koncepteve ligjore të së drejtës materiale ose procedurale në lidhje me konkluzionet e arritura për zgjidhjen e çështjes, duke bërë një analizë për qëllimin dhe funksionin përkatës të dispozitave, si dhe të zbrërthimit të kushteve apo elementëve të nevojshëm me qëllim që dispozita përkatëse të gjejnë zbatim në rastet konkrete në shërbim të konkluzioneve të arritura për zgjidhjen e çështjes.

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se vendimet gjyqësore dominohen nga procesi analitik dhe vlerësues të fakteve dhe provave në raport me njëra –tjetrën si dhe ligjin e

⁷² Vendimi i GJEDNJ, Cështja Dadjanastassion vs Greqisë, datë 16.12.1992, faqe 33.

zbatueshëm. Konstatohet se gjyqtarja, përgjithësisht përshkruan dhe analizon në mënyrë të qartë faktet e çështjes tek pjesa e analizës ligjore mbi faktet e çështjes, duke integruar në këtë analizë pjesë të provave ose faktet që rezultojnë prej tyre, çka e bën të qartë dhe të kuptueshme analizën e faktit dhe orienton me tej argumentimin logjik lidhur me pretendimet e palëve, në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes. Në vendimet gjyqësor, konkluzioni arrihet pas arsytimit dhe argumentimit ligjor.

Në vendimet burim vlerësimi gjyqtarja i kushton rëndësi analizës si të instituteve dhe koncepteve të caktuara të së drejtës, kur kjo rezulton e nevojshme, duke i kushtuar gjithashtu një rëndësi të posaçme edhe analizës së këtyre koncepteve në raport me rrethanat konkrete të çështjes, p.sh:

- (i) Institutin e të drejtës së pronës private, si një e drejtë e njohur dhe e garantuar nga Kushtetuta dhe Ligji, që u lejon pronarëve të gëzojnë tagrat e plota të pronësisë për pronat e tyre dhe mbron pronarin privat nga çdo pushtet apo veprim arbitrar, si ndaj një subjekti privat dhe ndaj shtetit, i cili nuk mund të përdor sovranitetin e tij për të marrë pronën e privatëve, përveçse në rastet e parashikuara në ligj për shpronësim për interes publik, përkundrejt një shpërblimi të drejtë, real dhe në përputhje me kushtet e tregut për pasurinë që shpronësohet. Po ashtu, trajton institutin e “shpronësimit de facto” duke iu referuar jurisprudencës së Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë duke cilësuar se përbën një nga format e ndërhyrjes së shtetit për interesa publikë në pronën private⁷³;
- (ii) Trajton konceptin e “padsisë së rivendikimit dhe të drejtat me natyrë personale që burojnë nga kjo padi” si një padi të pronarit joposuedes ndaj poseduesit jopronar, ku kërkohet vërtetimi i dy kushteve: legjitimitimi aktiv i palës paditëse (pronar i zhveshur tërësisht nga posedimi i sendit) dhe legjitimitimi pasiv i palës së paditur (posedues i paligjshëm i sendit dhe që në momentin e ngritjes së padsisë ka posedimin efektiv të sendit). Këtu trajton se padia e rivendikimit shoqërohet me kërkime të tjera si: shpërblim për përdorimin e tij dhe shpërblim për vlerën e sendit pronarit në pamundësi për të kthyer sendin, të cilat janë kërkime me natyrë personale/padi personale e detyrimi, por që vetë ligjvënësi i ka rregulluar me dispozita të së drejtës së pronës për shkak të koneksitetit të tyre, kjo në varësi të llojit të posedimit. Këtu, në interpretim të neneve 304, 305, 306 të Kodit Civil trajton konceptin e “posedimit dhe llojet e tij” si i ligjshëm dhe i paligjshëm (në mirëbesim, në keqbesim)⁷⁴;
- (iii) Institutin e “shpërblimit të dëmit jashtëkontraktor, pasuror dhe jopasuror” duke vlerësuar se për të qenë përpara këtij instituti duhet të plotësohen në mënyrë kumulative këto kushte: ekzistenca e dëmit, veprimet/mosveprimet e paligjshme, lidhja shkakësore dhe fajti⁷⁵;
- (iv) Trajton konceptet, e “aksidentit në punë” duke iu referuar përkufizimit të VKM 788/2000 dhe Ligjit nr. 10237/2010 mbi rrethanat e çështjes; konceptin e “dëmit”, “paligjshmërisë së veprimit/mosveprimit”, “fajit” si një kategori subjektive dhe qëndrimi psikik i personit ndaj veprës së tij dhe pasojave të ardhura, “lidhja shkakësore” e cila duhet të jetë

⁷³ Vendimi nr. 989, datë 28.02.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁷⁴ Vendimi nr. 989, datë 28.02.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁷⁵ Vendimi nr. 4858, datë 28.09.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

material dhe juridike; konceptet e dëmit “biologjik”, “moral”, “ekzistencial” duke iu referuar vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë si dhe analizës ligjore të normave materiale civile përkatëse⁷⁶ ;

- (v) Institutin e parashkrimit fitues pa titull, duke përmendur kushtet që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative që të jemi para këtij instituti: posedimi i sendit, posedimi për një kohë të caktuar, sendi të jetë i aftë për t’u fituar me parashkrim fitues. Lidhur me posedimin, interpreton nenin 304 të Kodit Civil, ku thekson se posedimi duhet të jetë i pandërprerë, i qetë, publikë, dhe poseduesi të ketë vullnet t’a mbajë sendin si të vetin⁷⁷
- (vi) Institutin e parashkrimit të kërkesës për ekzekutimin e detyrueshëm duke përdorur interpretim qëllimor, historik, sistematik. Kështu, Gjyqtarja interpreton nenin 112 të Kodit Civil lidhur me kuptimin e parashkrimit sipas të cilit është fakt juridik që sjell shuarjen e së drejtës subjektive, atë të padisë dhe të kërimit të ekzekutimit të titullit kur plotësohen dy kushte: mosveprimi i titullarit të së drejtës dhe kalimi i afatit të caktuar me ligj⁷⁸;
- (vii) Trajton konceptet e «*faturës së energjisë elektrike si titull ekzekutiv*», «*marrëdhënies juridike të detyrimit të furnizimit*» «*detyrimin që buron nga kontrata e cila përbën ligj për palët kontraktuale*», «*momentit që kërkitimi bëhet i ekzekutueshëm*»⁷⁹ ;
- (viii) Institutin e së drejtës së pronësisë dhe bashkëpronësisë mbi bazën e një titulli që rrjedh nga trashëgimia ligjore, institutin e bashkësisë ligjore dhe sendeve që përfshihen në të, institutin e regjistrimit të sendit të paluajtshëm në regjistrat publik dhe efektet e tij, duke përdorur interpretim qëllimor, historik, sistematik⁸⁰;
- (ix) Institutin e “trashëgimisë” i cili përmban një sërë kufizimesh mbi lirinë e testatorit dhe disponimin e pasurisë së tij. Kështu, ka dy mënyra të kalimit të pasurisë trashëgimore: me ligj dhe me testament. Trashëgimia me ligj është përjashtim nga rregulli kur nuk ka testament, testamenti disponon vetëm për një pjesë të pasurisë dhe testamenti është pjesërisht ose tërësisht i pavlefshëm. Gjyqtarja trajton institutin e “dhurimit” si një kontratë tipike ku dhuruesi synon të shtojë pasurinë e përfituesit duke pakësuar pasurinë e tij me anë të një veprimi të vullnetshëm. Dhurimi sipas gjyqtarës nuk pranohet kontratë paraprake për vetë natyrën e tij. Dhuruesi duke ekzekutuar një kontratë paraprake dhurimi do të vendosej në kushtet e përmbushjes së një detyrimi jo spontan, por i shtrënguar që vjen ndesh me elementin subjektiv që ka vetë dhurimi⁸¹ ;
- (x) Trajton konceptet e “testamentit” dhe “revokueshmërisë së testamentit”, “vullnetit të testatorit”, referuar analizës ligjore të normave materiale civile përkatëse. Kështu, Gjyqtarja analizon se testamenti si një veprim juridik i njëanshëm, përbën shfaqje e ligjshme e vullnetit të testatorit për disponimin e pasurisë pas vdekjes, brenda urdhërimeve të lëgjitshme. Një nga parimet që ndjek hartimi i testament është parimi i sigurisë së shprehjes së vullnetit të testatorit, një vullnet i cili duhet të jetë i qartë, pa ekuivokë për të gjithë përmbajtjen, veçanërisht për personin që do të përfitojë dhe pasurinë. Një karakteristikë e testamentit është revokueshmëria, në çdo kohë gjatë

⁷⁶ Vendimi nr. 4858, datë 28.09.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁷⁷ Vendimi nr.2486, datë 09.05.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁷⁸ Vendimi nr. 6123, datë 21.11.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁷⁹ Vendimi nr. 6123, datë 21.11.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁸⁰ Vendimi nr. 4960, datë 03.10.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁸¹ Vendimi nr. 1170, datë 07.03.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

qenies gjallë të testatorit. Kjo e dallon këtë veprim juridik të njëanshëm nga veprimet e tjera të njëanshme, por revokimi duhet të jetë i qartë. Po ashtu, gjyqtarja trajton konceptin e “përrjashtimit nga trashëgimia”⁸².

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve.

Arsyetimi i vendimeve përgjithësisht është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve ndërgjyqëse (që në disa raste shkon edhe në përsëritje të argumentave), për të konkluduar për bazueshmërinë ose jo të këtyre pretendimeve, në raport me faktet e provuara në gjykim dhe parashikimet e ligjit në raport me to. Në vendimet e analizuara, pretendimet e palëve janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor, në të cilën paraqiten në mënyrë të hollësishme në disa vendime në fillim të pjesës përshkrueses- arsyetuese dhe në disa raste pas rrethanave të çështjes. Analiza e këtyre pretendimeve, me natyrë procedurale, apo me bazueshmërinë e çështjes në themel, bëhet në pjesën e arsyetimit ligjor të vendimit, duke u pozicionuar dhe analizuar në pjesën e duhur të arsyetimit që ka të bëjë pikërisht me pretendimin konkret, duke marrë gjithmonë përgjigje të argumentuar në drejtim të mbështetjes në ligj ose prova të tyre.

Gjyqtarja e ka vlerësuar aftësinë e saj në drejtim të cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik në shkallë shumë të lartë, por nuk ka dhënë shpjegime.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, duke marrë si një e tërë, pa i dhënë peshë secilit prej tyre, rezulton gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në lidhje me treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Argumentimi për çdo konkluzion të arritur mbi çështjet e analizuara, si në aspektin procedural ashtu edhe në lidhje me themelin, ka në bazë një analizë të detajuar dhe të integruar të provave, interpretim të ligjit të zbatueshëm dhe aplikimin e tij mbi faktin konkret, duke evidentuar qartë marrëdhënien shkak-pasojë dhe mënyrën e zbatimit të dispozitave ligjore mbi një situatë të caktuar. Arsyetimi i vendimeve përgjithësisht është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje pretendimeve dhe kërkimeve të palëve ndërgjyqëse, duke përmbushur standardet e procesit të rregullt ligjor .

⁸² Vendimi nr. 1170, datë 07.03.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “cilësia e analizës dhe argumentit logjik” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë. Ky konkluzion bazohet në analizën e metodologjisë së përgjithshme të punës së gjyqtares në drejtim të këtij treguesi, duke analizuar të gjitha llojet e çështjeve të përzgjedhura, pa i dhënë peshë dhe rëndësi të veçantë asnjërës prej tyre.

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtares në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtarja përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A AFTËSIA E GJYQTARES PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË.

2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka gjykuar gjithsej 104 çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi, të cilat i përkasin kategorisë së çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtarë”, “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtarë”, “Tregtare pa palë kundërshtarë”.

Sipas të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se nga 104 çështje për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, 97 prej tyre janë shqyrtuar në tejkalim të këtij afati ndërsa 7 çështje janë shqyrtuar brenda afateve ligjore. Referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (97 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (104 çështje), gjyqtarja rezulton që të ketë gjykuar **93.2% të çështjeve jashtë afatit ligjor.**

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja e ka vlerësuar treguesin “Respektimi i afateve ligjore” në shkallë shumë të lartë duke shpjeguar ndër të tjera, se “...Nga ana tjetër largimi i shumë gjyqtarëve ka sjellë reduktimin e ndjeshëm të numrit të gjyqtarëve në detyrë/seksioni civil –tregtar/, gjë e cila do të thotë dhe rritjen e numrit të çështjeve të reja me afate kohore ligjore të shortuara për gjyqtar, si: masa sigurimi, kërkesa për rregjistrim dhe depozitim aktesh(ojf)etj.; në faktorë të tjerë ndikues posaçërisht për vitin 2022 lidhur me mosrepektimin e afateve ligjore do të përmendim dhe në këtë periudhë kohore duhet cituar impenjimi im në procesin e Rivlerësimit nga KPK i cili ka qenë shumë intensiv nga fundi i vitit 2021 deri në datë 10.06.2022 të vendimmarrjes/vendimi nr.540 datë 10.06.2022. Përgjatë kësaj periudhe kohore korrespondenca me KPK ka qenë shumë e vazhdueshme /përgjigje të pyetësorëve, marrje provash, dokumentash, përgatitja e relacionit shpjegues pas ardhjes së rezultateve të hetimit ,dhe deri në përfundim të procesit; -bojkoti i avokatëve, lidhur me problemet e hartës gjyqësor, për seancat përgatitore/gjyqësore përgjate vitit 2022 i cili zgjati disa muaj dhe që solli shtyrje të seancave duke pasur parasysh rëndësinë që ka e drejta e përfaqësimit në një proces të rregullt ligjor.... Referuar tabelës përkatëse, ku gjen pasqyrim kjo kategori çështjesh, gjejmë tejkallim të afateve të cilat kanë të bëjnë: -së pari, me ngarkesën shumë të madhe të gjyqtarëve/times personalisht/që reflekton detyrimisht dhe në trajtimin e këtyre çështjeve, -me çështje të ardhura nga gjyqtarë të mëparshëm për të cilat nuk evidentohet në statistika data e saktë e ardhjes për gjykim pranë meje si gjyqtare; -me faktin që data e shortimit, në përgjithësi ,nuk përputhet me datën e dorëzimit faktik të dosjes gjyqtarit, e cila dhe kjo ka një afat të konsiderueshëm/(e gjitha për shkak të ngarkesës në total në Gjykatën e Tiranës që reflekton domosdoshmërisht dhe në veprimet administrative); - me dhënien afat për plotësim të metash të cilat paraqiten jo rrallë here, apo me marrje të të dhënave nga organet kompetente (bashkia dhe tatimet) në kërkesat për likuidimin e Ojff, të cilat detyrimisht çojnë në zgjatje të afatit dhe mosrespektim të tij. Citojmë këtu disa çështje për të cilat kemi një afat më të gjatë kohor:

- -nr.33 akti dt. regj 11.05.2021 dhe datë përfundimi 05.03.2022 /kemi të bëjmë me likuidim shoqate dhe ku janë kërkuar konform ligjit dhe marrë nga gjykata të dhëna nga të tretë (Bashkia dhe Tatimet/vonesa të tyre) gjë e cila ka ndikuar në afatin e shqyrtimit;
- -nr.39 akti, dt rregjistrimi 14.06.2021 dhe datë përfundimi 29.06.2022/kemi të bëjmë me depozitim vendimesh të Kongresit të Partisë ‘Lëvizja Demokratike për ndryshim’, e mbajtur në seance verbale dhe ku nga gjykata është kërkuar plotësim dokumentacioni/(në përfundim pushim gjykimi);
- -nr.43 akti datë rregj 17.06.2021 dhe datë përfundimi 24.01.2022-çështja ka ardhur nga gjyqtarja Rezarta Balliu në datë 23.07.2021 dhe në vijim kemi pasur dhënie kohe për plotësim aktesh dhe më pas kthimin e tyre;
- -nr.72 akti datë regjistrimi 19.07.2021 dhe datë përfundimi 07.09.2022- kjo dosje ka qenë me parë të gjyqtare Anila Capo dhe ka ardhur pranë meje faktikisht në datë 16.06.2022 dhe kemi kthim aktesh;
- -nr.191 akti datë rregjistrimi 03.12.2021 dhe datë përfundimi /kthim aktesh/11.04.2022/ - ky afat nuk duhet të llogaritet te unë si gjyqtare pasi ka ardhur nga gjyqtare Teuta Hoxha më datë 13.02.2023;
- -nr.381 akti datë rregjistrimi 31.01.2022 datë përfundimi 19.05.2022- kemi dhënie afati për plotësim aktesh ;

- -nr.397 akti atë regjistrimi 03.02.2022 dhe datë përfundimi 10.05.2022- dhënë afat për plotësim të metash dhe në vijim kthim aktesh;
- -nr.409 dhe 426 aktesh datë regjistrimi përkatësisht 7.02.2022 dhe 10.02.2022- ardhur nga gjyqtarë të tjerë;
- -nr.440 Akti datë rregjistrimi 14.02.2022 dhe datë përfundimi 17.05.2022-dhënie afati për plotësim aktesh;
- -nr.535 akti datë rregjistrimi 02.03.2022 dhe datë përfundimi 04.07.2022 - dhënie afati për plotësim të metash /në vijim kthim aktesh
- -nr.648 akti datë rregjistrimi 06.04.2022 dhe datë përfundimi 07.09.2022-aktet me të meta është pritur plotësimi i tyre ;
- -nr.668 akti dt rregjistrimi 08.04.2022 dhe datë përfundimi 14.10.2022-dhënie afati për plotësim aktesh;
- -nr.699 akti dt rregj 19.04.2022 dhe datë përfundimi 13.10.2022 – kemi plotësim të metash dhe në vijim kthim aktesh;
- -nr.838 akti dt rregjistrimi 31.05.2022 dhe datë përfundimi 29.06.2022 –dhënie afati për plotësim aktesh ;
- -nr.859 akti dt rregjistrimi 07.06.2022 dhe datë përfundimi 03.11.2022 - kemi dhënie afati për plotësim të metash;
- -nr.908 akti dt rregjistrimi 21.06.2022 dhe datë përfundimi 07.10.2022 –është dhënie afat për plotësim aktesh ;
- -nr.968 akti datë regjistrimi 2.07.2022 dhe datë përfundimi 08.11.2022-dhënie afati për plotësim aktesh;
- nr.988 akti datë rregjistrimi 18.07.2022 dhe datë përfundimi 14.11.2022 - dhënie afati për plotësim aktesh dhe në vijim kthim aktesh;
- -nr.1049 akti dt 09.08.2022 rregjistrimi dhe datë përfundimi 20.12.2022-dhënie afati për plotësim të metash;
- nr.1140 akti dt rregjistrimi 22.09.2022 dhe datë përfundimi 01.11.2022/me seancë verbale me pjesëmarrje të subjektit.

(duhet të theksojmë se dhënia e afatit nga gjykata nga njëra anë i jep mundësi palëve të plotësojnë aktet dhe mos i drejtohen gjykatës disa herë, por nga ana tjetër kjo ndikon ndjeshëm në afat të gjyqtarit përsa kohë shpesh herë njoftimi i palës merr një kohë të konsiderueshme për shkak adresë të deklaruar, vonesë të nëpunësve që merren me njoftimin e akteve, apo kërkimit dhe të një afati tjetër për plotësim,etj)..”

Në përlogaritjen e afateve ligjore, për të gjitha dosjet, përlogaritja e afateve do të fillojë nga data e shortimit (pra, data kur çështja ka shkuar pranë gjyqtares), dhe jo ajo e regjistrimit. Në të gjitha dosjet, në përlogaritje do të zbriten:

- leja vjetore e muajit gusht prej 35 ditësh (ligji parashikon 25 ditë pune për gjyqtarët apo 35 ditë kalendarike) ;
- festat e fundvitit dhe disa ditë të mbartjes së dosjeve. 6 ditë ;
- raportet për paaftësi të përkohshme në punë: 17 - 21 tetor 2022 (5 ditë) ;
- mungesa të justifikuara në punë : 21-25 mars 2022 (5 ditë), 23-26 maj 2022 (4 ditë) dhe 7-8 qershor 2022 (2 ditë).

Kështu, referuar tabelave me të dhëna statistikore, rezulton si vijon:

- (i) në tabelen nr.1, « *Civile me palë kundërshtare* », çështjet me nr.rendor 11, 140 dhe 146, me objekt «*Kundërshtim veprimi përmbarrimor*» kanë përfunduar përkatësisht për 25, 24 dhe 33 ditë, pra jashtë afatit 20 ditorë të parashikuar nga neni 610 i K.Pr.Civile. Pasur parasysh shpjegimet e gjyqtares, lidhur me faktin se data e shortit nuk përkon me datën e marrjes së çështjes në dorëzim e cila varion në 1-3 ditë, si dhe tejkalimin me vetëm 4-5 ditë nga afati 20 ditorë, ky tejkalimi do të konsiderohet i papërfillshëm e për pasojë çështja do të konsiderohet si e përfunduar **brenda afatit 20 ditor të parashikuar nga ligji.**
- (ii) në tabelën nr. 2, «*civile pa palë kundërshtare*» çështjet me nr. rendor 44 me objekt «*Kërkesë civile me masë sigurimi*»⁸³, është shortuar me 16.05.2022 dhe ka përfunduar në 20.05.2022, për 4 ditë, pra **brenda afatit 20 ditor të parashikuar nga ligji.**
- (iii) në tabelën nr. 2, «*civile pa palë kundërshtare*» çështjet me nr. rendor 44 me objekt «*Kërkesë për caktim përfaqësuesi ligjor*»⁸⁴, është shortuar në 28.10.2022 dhe ka përfunduar në 08.11.2022, për 11 ditë. Tejkalimi me 1 ditë do të konsiderohet i papërfillshëm e për pasojë çështja do të konsiderohet si e përfunduar **brenda afatit 10 ditor të parashikuar nga ligji.**
- (iv) në tabelën nr. 6, çështje «*tregtare pa palë kundërshtare*» çështje me nr. rendor 44 me objekt «*Regjistrim fillestar*»⁸⁵, është shortuar në 01.06.2022 dhe ka përfunduar në 17.06.2022, për 16 ditë. Tejkalimi me 1 ditë do të konsiderohet i papërfillshëm e për pasojë çështja do të konsiderohet si e përfunduar **brenda afatit 15 ditor të parashikuar nga ligji.**

Për pasojë, duke konsideruar shpjegimet e mësipërme **5 çështjet e mësipërme do të konsiderohen si të përfunduara brenda afatit ligjor.**

Analiza e të dhënave statistikore nga ana e vlerësuesit duhet bërë në mënyrë të tillë që të shmangen përfundimet që vijnë për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtares. Për analizën e këtij treguesi, vlerësuesi nuk bazohet vetëm në të dhënat statistikore, por merr në konsideratë të gjitha të dhënat dhe burimet e tjera të vlerësimit. Duke iu referuar tabelave me të dhënat statistikore si dhe çështjeve të analizuarra më sipër, rezultoi se numri i çështjeve me afat ligjor

⁸³ Neni 202 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se: «*Me kërkesën e paditësit, gjykata brenda 5 ditëve lejon marrjen e masave për sigurimin e padisë, kur ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit për të drejtat e paditësit do të bëhet i pamundur ose i vështirë.*» Në tabelën numër 2 janë etiketuar si çështje me afat standard minimal, por në fakt këto çështje kanë afat të përcaktuar në ligj, ndaj do të përlogariten si të tilla.

⁸⁴ Neni 522 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se: «*Kur banimi i debitorit nuk dihet, gjykata e shkallës së parë e vendit të ekzekutimit, me kërkesën e përmbarruesit gjyqësor, pasi sqarohet edhe vetë për këtë rrethanë, brenda 10 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së përmbarruesit gjyqësor i emëron debitorit një përfaqësues, i cili shpërblehet fillimisht nga kreditori sipas nenit 525 të këtij Kodi.*»

⁸⁵ Neni 31 i Ligjit Nr. 80/2021 «*Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse*» (në fuqi në kohën e zbatimit të procedurës) parashikon se: «*1. Gjyqtari, me përjashtim të rasteve kur ka pezulluar shqyrtimin e kërkesës sipas nenit 29 të këtij ligji, vendos për kërkesat e regjistrimit ose të çregjistrimit në dhomë këshillimi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e depozitimit të kërkesës në sekretarinë e regjistrimit ose në formë elektronike. 2. Vendimi për regjistrimin jepet nga gjyqtari edhe në rastin kur një gjykatë tjetër ka marrë vendim për kryerjen e këtij veprimi.*»

është 104 çështje. Po ashtu në numrin e çështjeve me afat ligjor, të përfunduara tej këtij afati (97 çështje), duhet të zbriten 5 çështje, pasi referuar analizës për secilën prej tyre, rezultoi se ato duhet të konsiderohen të përfunduara brenda afatit ligjor. Në këtë mënyrë, raporti i çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (92 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (104 çështje), rezulton të jetë 88.46 %, përqindje e cila sipas Metodologjisë pikëzohet me 3 pikë (mbi 40 %- 3 pikë).

Në metodologjinë e pikëzimit, lidhur me këtë tregues, është përcaktuar hapësira e vlerësuesit për të përcaktuar një shkallë më të lartë pikëzimi, deri në një pikëzim maksimal, bazuar në analizën e të dhënave që rezultojnë nga analiza e të gjithave burimeve të vlerësimit, nisur nga tregues të tillë si: kompleksiteti i çështjeve, ngarkesa e gjyqtarës, rritja e volumit të punës, apo aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës së tij, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarës.

Në rastin konkret, në lidhje me aspektin sasior të volumit të çështjeve të përfunduara, rezulton se gjyqtarja ka përfunduar në total për gjithë periudhën 1-vjeçare objekt vlerësimi (01.01.2022 - 31.12.2022), 1097 çështje, nga të cilat 104 çështje parashikojnë afati ligjore gjykimi. Rezultoni se nga numri i përgjithshëm i çështjeve, 194 çështje janë me palë kundërshtare dhe 903 çështje pa palë kundërshtare, nga të cilat 772 janë urdhëra ekzekutimi, 62 kërkesa për regjistrim dhe depozitim OJF apo parti politike, ku këto të fundit kërkojnë shpejtësi gjykimi.

Lidhur me përcaktimin e aspektit sasior, në pikën 3, shkronja “a” dhe “e” të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve, të miratuar me vendimin nr.261/2, datë 14.04.2010 të KLD, përcaktohet se; *Standardi sasior i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari brenda një viti kalendarik të një ngarkesë pune minimale si më poshtë; e. Gjyqtari i shkallës së parë i dhomës civile, si relator, i seksionit të përgjithshëm, jo më pak se 120 gjykime çështjes që kanë të bëjnë me mosmarrëshje mes palëve kundërshtare. ë. Gjyqtari i shkallës së parë, i dhomës civile e penale, shqyrton jo më pak se 400 çështje të natyrës kërkesa (civile ose penale) me ose pa palë të interesuara*”. Në rastin konkret, gjatë periudhës së vlerësimit, gjyqtarja ka përfunduar 194 me palë kundërshtare, ose 61.7 % çështje më shumë seç është e përcaktuar në Vendimin nr. 261/2, datë 14.04.2010 të ish-KLD-së në lidhje me çështjet me palë kundërshtare dhe ka përfunduar 903, kërkesa pa palë kundërshtare ose 125.7 % çështjet të natyrës kërkesa, duke e kaluar standardin sasior në fuqi.

Në lidhje me rritjen e volumit të punës si dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, rezultoi se gjatë vitit 2022 gjyqtarës i janë caktuar me short si relatore 1014 çështje, nga të cilat 316 janë çështje me palë kundërshtare dhe 698 kërkesa. Gjatë vitit 2022, gjyqtarja ka qenë e angazhuar me procesin e vlerësimit kalimtar deri në datë 10.06.2022 (datë kur nga KPK është dhënë vendimi për konfirmimin e saj në detyrë.

Edhe kryetari i Gjykatës e vlerëson maksimalisht këtë tregues.

KONKLuzioni

Analiza e të dhënave statistikore nuk bëhet nga vlerësuesi në mënyrë matematikore, por është një analizë logjike e të dhënave burimore. Në përcaktimin e nivelit të pikëzimit konsiderohen në rastin konkret:

- i) ngarkesa e gjyqtarës si relatores gjatë vitit 2022 (në total ka gjykuar 1097 çështje si relatores, nga të cilat 194 janë çështje me palë kundërshtare dhe 903 kërkesa (pa palë kundërshtare), duke e tejkaluar standardin sasior mesatare me 61.6 % me palë kundërshtare dhe me 125.7 % me kërkesa civile;
- ii) numrin e lartë të çështjeve të caktuara gjatë vitit 2022, rreth 1014 çështje dhe numrin e lartë të çështjeve të mbartuara 1083 çështje;
- iii) vetëvlerësimi i gjyqtarës lidhur me shkaqet objektive që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimeve;
- iv) numri i çështjeve me afat ligjor, pasi rezulton se ka përfunduar 104 çështje me afat ligjor, të cilat përbëjnë rreth 9.5 % të çështjeve të shqyrtuara prej saj në vitin 2022, numër i cili është relativisht i ulët;

Sa më sipër, referuar analizës logjike të të dhënave vlerësohet se për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet me një nivele të ndryshëm se pikëzimi që rezulton nga të dhënat statistikore, duke u pikëzuar me 12 pikë, por kurrësi nuk duhet të shkojë në një pikëzim maksimal, pasi përqindja e lartë e çështjeve të shqyrtuara jashtë këtij afati nuk mund të justifikojë një pikëzim të tillë.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarës për treguesin “Respektimi i afateve ligjore”, duhet të konsiderohet e lartë, brenda marzhit “11-20 %”, duke e pikëzuar 12 pikë.*

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka gjykuar gjithsej 993 çështje për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, të cilat i përkasin kategorive të çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, “Tregtare me palë kundërshtare”, “Tregtare pa palë kundërshtare”, “Marrëdhënie pune”, për të cilat vendimi nr. 261/2, datë 14.04.2010, i KLD përcakton këto standarde minimale kohore për gjykimin në gjykatën e shkallës së parë, si vijon:

- jo më tej se 6 muaj (180 ditë) për gjykimet civile të themelit;
- jo më tej se 4 muaj (120 ditë) për gjykimet familjare;
- jo më tej se 9 muaj (270 ditë) për krimet me maksimumin e dënimit deri në 10 vjet dhe 12 muaj (365 ditë) për krimet me minimumin e dënimit jo më pak se 10 vjet;
- jo më tej se 4 muaj (120 ditë) për kundërvajtjet penale;

- jo më tej se 2 muaj (60 ditë) për gjykimin e kërkesave civile pa palë kundërshtare;
- jo më tej se 2 muaj (60 ditë) për gjykimin e kërkesave administrativo-penale.

Sipas të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se nga 993 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 814 prej tyre ose **81.9 % janë gjykuar tej standardit minimal kohor në fuqi.**

Në formularin e integruar të vlerësimit, gjyqtarja e ka vlerësuar treguesin “*plotësimi i standardeve minimale kohore*” në shkallë shumë të lartë. Referuar këtij treguesi, gjyqtarja shprehet “*...Në çdo rast këto standarde nuk i përgjigjen realitetit përse kohë që në vitin 2022 të vlerësimit respektimi i tyre mbetet i paarritshëm megjithë impenjimin maksimal të gjyqtarëve që ndodhen nën peshën e një ngarkese shumë të madhe. Puna e gjyqtarit për vetë natyrën e saj nuk fillon dhe mbaron me orët/orarin e punës dhe kjo dhe në një ngarkese normale përse duhet jo thjesht të caktoj dhe të drejtoj seanca përgatitore/gjyqësore ditë pas ditë, por duhet të lexoj dhe azhurnohet në vijimësi me praktikën e reja brenda dhe jashtë vendit, me ndryshimet e legjislacionit, të studioj çështjen/t në tërësi dhe të arsyetoj vendimet, etj. Vetëm në një situatë normale mund të kërkohet mbi bazë statistike dhe pretendohet respektimi i afatit /standartit minimal ligjor/. Ndërkoh që në statistikën e nxjerra për vitin 2022 gjejmë në kolonat përkatëse afatin/standarti minimal kohor/që paraqet problematika në lidhje me respektimin e tij. Në lidhje me sa më lart duhet domosdoshmërisht të evidentohen disa rrethana fakti tepër domethënëse dhe të cilat nuk mund të anashkalohen pa u marrë në konsideratë... Personalisht (por dhe nga diskutimi me shumë nga kolegët) dosjet e ardhura nga gjyqtarët e tjere apo për shkak të tyre dhe dosjet e reja nuk janë vënë në lëvizje menjëherë/ka rezultuar e pamundur; -një faktor tjetër në mosrespektimin e afateve është dhe ngarkesa e madhe e punës edhe për administratën gjyqësore duke filluar nga sekretaret gjyqësore dhe deri te nëpunësit/ftuesit e gjykatës. Për shkak të ngarkesës së madhe administrata nuk arrin në kohë reale të kryej veprimet përkatëse, si: njoftimi i akteve palëve; menaxhimi në kohë i dosjeve në kontekstin e veprimeve administrative, etj. Po ashtu ka qenë i pamundur menaxhimi i mbikëqyrjes së realizimit të njoftimeve nëpërmjet nëpunësve të gjykatës dhe veçanërisht të postës ku shpeshherë seancat e caktuara përgatitore apo gjyqësore nuk janë zhvilluar për shkak të këtyre mangësive, megjithë reklamimet tona/kryesisht verbale në lidhje me këtë çështje.*

Çështjet civile gjithmonë përballen me problematikën e njoftimit të palëve për shkak të adresës apo dhe numrit të madh të tyre, dhe ku gjykata është e detyruar që të bëjë në çdo rast një verifikim të plotë (marrjen e të dhënave të mëtejshme nga pala paditëse apo nga rregjistri kombëtar i gjendjes civile, etj) përgjatë veprimeve paraprake në gjetjen e tyre me qëllimin komunikimin e akteve/kjo mund të ndodhë dhe përgjatë gjykimit kur lind domosdoshmëria e njoftimit të palëve. Të gjitha këto ndikojnë ndjeshëm në respektimin e afateve kohore”.

Lidhur me analizën logjike të të dhënave dhe përjashtimin e rrethanave që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarës, gjejmë mbështetje në Skemën e Vlerësimit të Gjyqtarëve, pasi:

Së pari, standardet minimale kohore nuk janë afate të arsyeshme. Ato nxisin gjyqtarin të jetë sa më produktiv, pavarësisht ngarkesës në punë. Standardet orientuese janë indikator matës i performancës së gjyqtarit. Ndërsa qëllimi i afateve të arsyeshme nuk është përcaktimi në mënyrë taksative i afateve të arsyeshme të gjykimit të çështjeve për gjyqtarin në vetvete, por si afate maksimale për përfundimin e tyre, shkelja e të cilave legjitimon kërkuesin palë në proces që të kërkojë dëmshpërblim.

Së dyti, afatet e përcaktuara me vendimin nr. 261/2 të ish KLD-së për përfundimin e çështjeve (civile apo penale) kanë qenë dhe ende janë afate orientuese në funksion të menaxhimit dhe efikasitetit të çështjeve gjyqësore nga ana e gjyqtarit. Këto afate orientuese shërbejnë si një standard matës për efekt të vlerësimit të gjyqtarëve, nëse ata në punën e tyre kanë ndërmarrë një rol të vëmendshëm në planifikimin e seancave gjyqësore dhe në sigurimin e administrimit efikas të seancave gjyqësore, e për rrjedhojë të përfundimit të çështjeve në një kohë sa më të shkurtër. Nga ana tjetër, tejkalimi i këtyre afateve orientuese, nuk nënkupton shkeljen e standardit të procesit të rregullt ligjor parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 të KEDNJ-së.

Së treti, afatet e nevojshme për kryerjen e veprimeve procedurale të detyrueshme për tu zbatuar (*njoftimi i deklaratës së mbrojtjes, njoftimi me shpallje për palët...etj.*), apo edhe ato opsionale për tu zbatuar (*shpallja e arsyetuar e vendimit, etj.*) llogariten në afatin standard orientues të gjykimit të çështjes. Standardet orientuese përfshijnë në vetvete edhe kohën që i duhet gjyqtarës për kryerjen e veprimeve procedurale, të tilla si: shtyrjen deri në 20 ditë për shpallje të arsyetuar të vendimit; shtyrjen deri në tre ditë për tu shprehur në lidhje me kërkesat e palëve ; respektimin e afatit 30/ditor për paraqitjen e deklaratës së mbrojtjes ; afatit 20/ditor për njoftimin e palëve me shpallje, afati 5/ditor për paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare me shkrim (neni 302/2 i K.Pr.Civile) etj.

Së katërti, afatet të cilat nuk janë në funksion të procesit (*si p.sh. afati 35 ditë ne muajin Gusht - leja vjetore*) apo afatet të cilat ecin për shkak të disa veprimeve procedurale (*si p.sh. koha e kaluar nga pezullimi i çështjes deri në rifillimin e saj, koha e kaluar nga data e ankimit të një vendimi të ndërmjetëm, faza e parë e pjesëtimit, ankim ndaj pezullimit të çështjes, parashtrimi i konfliktit të kompetencës Gjykatës së Lartë, etj.*), janë afate, të cilat nuk duhet të llogariten në afatin orientues, pasi ato nuk ecin jo për shkak të menaxhimit jo të mirë të çështjes nga ana e gjykatës. Në këtë kontekst, këto afate nuk duhet të llogariten në kohëzgjatjen e gjykimit, për aq sa rezultojnë të referuara nga ana e gjyqtarit për çështje konkrete apo nga të dhënat e pasqyruara në tabelat statistikore. Po kështu duhet mbajtur në vëmendje edhe caktimi i gjyqtarit si relatore i çështjes, në ato raste kur çështja është shortuar pas dhënies së dorëheqjes apo përjashtimit të gjyqtarëve të tjerë. Në rastin konkret nuk rezulton që gjyqtarja të ketë referuar të dhëna për kohën e pezullimit për çështje konkrete, duke pamundësuar identifikimin dhe analizën e këtyre çështjeve. Për pasojë, në rastin konkret, duke iu referuar tabelave me të dhëna statistikore, e vetmja e dhënë objektive që rezulton është kohëzgjatja e gjykimit e ndikuar nga leja vjetore në muajin gusht, e cila do të analizohet dhe zbritet në çështjet respektive.

Në përlogaritjen e standardit minimal kohor, për të gjitha dosjet, përlogaritja e afateve do të fillojë nga data e shortimit (pra, data kur çështja ka shkuar pranë gjyqtares), dhe jo ajo e regjistrimit. Në të gjitha dosjet, në përlogaritje do të zbriten:

- leja vjetore e muajit gusht prej 35 ditësh (ligji parashikon 25 ditë pune apo 5 javë kalenderike për gjyqtarët);
- festat e fundvitit dhe afati i mbartjes së dosjeve 10 ditë ;
- raportet për paaftësi të përkohshme në punë: 17-21 tetor 2022 (5 ditë) ;
- mungesa të justifikuara në punë : 21-25 mars 2022 (5 ditë), 23-26 maj 2022 (4 ditë) dhe 7-8 qershor 2022 (2 ditë).

Duke mbajtur në konsideratë analizën e sipërcituar, vlerësohet që të konsiderohen si çështje të cilat kanë përfunduar brenda standardit minimal kohor çështjet si më poshtë:

- (i) në tabelën nr. 1, 4 çështjet civile me palë kundërshtare me nr. rendor 46, 68, 95, 118, 124, 130, 132 dhe 134 janë gjykuar për 224 ditë, 218 ditë, 196 ditë, 218 ditë, 184 ditë, 233 ditë, 207 ditë dhe 214 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e pushimeve vjetore të muajit gusht dhe kohën e festave të fundvitit dhe mbartjes së dosjeve, raportet për paaftësi të përkohshme në punë apo mungesat e justifikuara rezulton që çështjet janë gjykuar për 178 ditë, 172 ditë, 150 ditë, 172 ditë, 143 ditë, 187 ditë, 161 ditë dhe 168 ditë. Tejkalmi i afatit me vetëm pak ditë për njërin nga çështjet do të konsiderohet i papërfillshëm dhe çështjet do të konsiderohen të gjykuara ***brenda standardit minimal kohor prej 6 muaj (180 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.***
- (ii) Në tabelën nr. 2, çështjet civile pa palë kundërshtare me nr. rendor 22, 25, 47, 235, 236, 239, 320, 405, 406, 460, 465, 531, 532, 533, 635, 652, 654, 742, 743, 748, 764, 786, 791, 802, 804, 829 dhe 836 janë gjykuar për 62 ditë, 64 ditë, 101 ditë, 68 ditë, 64 ditë, 67 ditë, 69 ditë, 69 ditë, 69 ditë, 64 ditë, 64 ditë, 73 ditë, 73 ditë, 73 ditë, 100 ditë, 104 ditë, 104 ditë, 105 ditë, 64 ditë, 105 ditë, 70 ditë, 67 ditë, 105 ditë, 75 ditë, 70 ditë, 81 ditë dhe 69 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e festave të fundvitit dhe mbartjes së dosjeve, e kohën e pushimeve vjetore të muajit gusht, raportet për paaftësi të përkohshme në punë apo mungesat e justifikuara rezulton që çështjet janë gjykuar për 27 ditë, 59 ditë, 64 ditë, 62 ditë, 64 ditë, 60 ditë, 63 ditë, 63 ditë, 63 ditë, 58 ditë, 58 ditë, 38 ditë, 38 ditë, 38 ditë, 65 ditë, 64 ditë, 64 ditë, 65 ditë, 59 ditë, 65 ditë, 64 ditë, 61 ditë, 67 ditë, 44 ditë, 39 ditë, 46 ditë dhe 64 ditë. Tejkalmi i afatit deri me 7 ditë do të konsiderohet i papërfillshëm dhe çështjet do të konsiderohen të gjykuara ***brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj (60 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.***
- (iii) Në tabelën nr. 5, çështja tregtare me palë kundërshtare me nr. rendor 14 është gjykuar për 215 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes lejen vjetore të muajit gusht dhe raportet për paaftësi të përkohshme në punë apo mungesat e justifikuara çështja rezulton e gjykuar për 169 ditë, ***brenda standardit minimal kohor prej 6 muaj (180 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.***

Pra, janë gjithsej 36 çështje që do të llogariten të gjykuara brenda standardit minimal kohor dhe do t'i zbriten numrit prej 814 çështjesh të përlllogaritura në raportin analitik, duke mbetur kështu 778 çështje.

Duke konsideruar sa më sipër, numri total i çështjeve për të cilat parashikohet standardi minimal kohor është 993 dhe numrit total të çështjeve të përfunduara jashtë standardit minimal kohore cila nuk është më 814, por rezulton të jetë 778 çështje, ose 78.3% e numrit total të çështjeve për të cilat zbatohet standardi minimal kohor. Sipas “*Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarës*”, të miratuar me vendimin me Nr. 264, datë 21.11.2019 të KLGJ, përqindja matematikore prej 78.3 % përkon me nivelin e vlerësimit 1 (një) pikë (+40% - 1 pikë).

Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, përcaktohet se: “*Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarës. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë se ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzim maksimal, nëse gjyqtarja ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50 % të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli.*”

Në rastin konkret, në lidhje me aspektin sasior të volumit të çështjeve të përfunduara, rezulton se gjyqtarja ka përfunduar në total për gjithë periudhën 1-vjeçare objekt vlerësimi (01.01.2022-31.12.2022), 1097 çështje, një numër tejet i lartë, duke e tejkaluar standardin sasior për çështjet me palë kundërshtare me 61.6 % dhe për çështjet pa palë kundërshtare (kërkesa) me 125.7 %⁸⁶.

Edhe kryetari i Gjykatës e vlerëson maksimalisht këtë tregues.

KONKLUZIONI

Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me: (i) raportin e çështjeve të gjykuara tej standardit (778 çështje) me numrin total të çështjeve për të cilat zbatohet standardi (993 çështje) që rezulton 78.3% ; (ii) numrin e ulët të gjyqtarëve detyrë, të cilët janë mbingarkuar edhe me rishortimin e çështjeve të lëna nga gjyqtarët e shkarkuar (iii) ngarkesën e gjyqtarës si relatore (në total për 1 vit ka gjykuar 1097 çështje); (iv) faktin se ajo e ka tejkaluar standardin sasior mesatare me 61.6 % për çështjet me palë kundërshtare dhe me 125.77 % me çështjet pa palë kundërshtare; (v) faktin se gjatë vitit 2022 gjyqtarës i janë caktuar 1014 çështje në gjykim, nga të cilat 316 janë me palë kundërshtare; (vi) faktin që përgjatë vitit 2022 gjyqtarja

⁸⁶ Në vendimin nr. 261/2, viti 2010, të ish KLD-së, lidhur me standardin sasior, në pikën 3, shkronja e) dhe ë), parashikohet se “*Gjyqtari i shkallës së parë i dhomës civile, si relator, i seksionit të përgjithshëm, jo më pak se 120 gjykime çështjes që kanë të bëjnë me mosmarrëeshje mes palëve kundërshtare. ë. Gjyqtari i shkallës së parë, i dhomës civile e penale, shqyrton jo më pak se 400 çështje të natyrës kërkesa (civile ose penale) me ose pa palë të interesuara*”

ka qenë në proces rivlerësimi dhe (vii) shpjegimet e gjyqtares, vlerësohet se për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet me një pikëzim të ndryshëm nga ai që i përket të dhënave statistikore duke arritur deri në pikëzimin maksimal.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “respektimi i standardeve minimale kohore” gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë, pasi shqyrtimi i 78.3 % të çështjeve jashtë standardit minimal kohor, ka ardhur përgjithësisht për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtares, sikundër është treguesi sasior i punës së saj (tejkallim i standardit sasior me 61.6 % për çështjet me palë kundërshtare dhe ne 125.7 të çështjeve pa palë kundërshtare) si dhe numri i lartë i çështjeve të caktuara brenda vitit (1014 çështje).

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, krahasuar me standardin minimal kohor në fuqi sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010, të KLD, për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykim, është si më poshtë:

- i. Në kategorinë e çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 284 ditë, pra **më e gjatë** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 6 muaj;
- ii. Në kategorinë e çështjeve “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 168 ditë, pra **më e gjatë** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj;
- iii. Në kategorinë e çështjeve “Tregtare me palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 202 ditë, pra **më e gjatë** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 6 muaj;
- iv. Në kategorinë e çështjeve “Tregtare pa palë kundërshtare”, e cila është vetëm një çështje, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 25 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar prej 2 muaj;
- v. Në kategorinë e çështjeve “Marrëdhënie pune”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 249 ditë, pra **më e gjatë** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 6 muaj.

Referuar të dhënave statistikore, rezulton se kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara është më i gjatë se standardi për shumicën e kategoritë e çështjeve, pasi nga 5 (pesë) kategori çështjesh, standardi minimal është tejkaluar për 4 (katër) prej tyre dhe koha mesatare është respektuar vetëm në një kategori, e cila në fakt është vetëm 1 çështje nga 993 çështje për të cilat respektohet standardi minimal. Referuar metodologjisë së Pikëzimit, kjo llogaritje matematikore përkon me një pikëzim prej 2 pikësh.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja, e ka vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë duke theksuar se: *“Themi "Shumë e lartë" bazuar pikërisht në analizën e bërë të raportit ngarkesë/impenjim-arritjet e këtij viti. Gjykata e Tiranës ka mbajtur dhe përballuar në këtë periudhë një peshë shumë të madhe megjithë kapacitetin e ulët njerëzor dhe kjo falë dedikimit të gjyqtarëve në detyrë/sakrificës ,lodhjes dhe punës së tyre. Në kohën mesatare që i dedikohet çdo çështje vihet theksi në atë që ngarkesa shumë e madhe (referuar volumit të çështjeve të ngarkuara për gjykim në këtë vit-të mbartura dhe rishtazi) passjell dhe afate më të gjata kohore nga një seancë në tjetrën dhe në këtë kontekst duhet gjykuar dhe koha mesatare për çdo çështje. Ngarkesa e madhe rrit artificialisht kohën mesatare të çdo çështje. Në përcaktimin e datave të seancave mbahet në konsideratë dhe çështja konkrete-natyra, koha e gjykimit, veprimi procedural vijues, etj. Po ashtu theksojmë se çështjet me natyrë civile (sidomos me palë kundërshtare) shfaqen përgjithësisht komplekse si nga vetë themeli, ndërëgjyqësia, të provuarit, etj të cilat të gjitha reflektohen në afate të gjata gjykimi.”*

Edhe kryetari i Gjykatës e vlerëson maksimalisht këtë tregues.

Në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se për të bërë pikëzimin e këtij treguesi, të dhënat statistikore analizohen sipas situatës për të shmangur përfundimet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarës.⁸⁷

KONKLUZIONI

Referuar metodologjisë dhe të dhënave statistikore, duke qenë se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më e gjatë se standardi procedural për shumicën e kategorive të çështjeve, konkretisht për 4 nga 5 çështje, dhe tek një kategori e cila është gjykuar brenda afatit është vetëm një çështje, gjyqtarja duhet të pikëzohet me 2 pikë. Por duke marrë në konsideratë volumin e çështjeve të shqyrtuara nga gjyqtarja gjatë periudhës së vlerësimit (1097 çështje), numrin teje të lartë të çështjeve të caktuara brenda këtij viti (1014 çështje, nga të cilat 307 janë me palë kundërshtare dhe 698 kërkesa) dhe atyre të mbartuara nga viti 2021, 1083 çështje, faktet e tjera të përmendura më sipër, vlerësohet që niveli i vlerësimit duhet të jetë më i lartë se ai që i korespondon pikëzimit të përcaktuar në tabelën përkatëse, duke e pikëzuar me 4 pikë.

⁸⁷ Metodologjia e Pikëzimit për këtë tregues parashikon se : *“...Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarës. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzimin maksimal”.*

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje duhet të konsiderohet “Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve” dhe për këtë arsye gjyqtarja pikëzohet me 4 pikë.

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, për të gjithë periudhën e vlerësimit, viti kalendarik 2022 si raport midis numrit të çështjeve të përfunduara (1097 çështje) me numrin e çështjeve të caktuara (1014 çështje) brenda periudhës së vlerësimit, **është 108 %** përqindje e cila sipas Metodologjisë pikëzohet me 10 pikë, duke qenë se rezulton +99%.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë. Ndër të tjera gjyqtarja thekson: *“Në momentin që gjyqtari përballet me një ngarkesë në absolut jashtë normales kjo passjell një numër shumë më të vogël të seancave përgjatë vitit kalendarik për secilën çështje dhe pamundësinë e përfundimit të saj në kohë duke pasur këtu parasysh dhe faktin e shtyrjeve të seancave apo dhe faktorët e tjerë që minimizojnë shumë mundësinë e përfundimit të çështjeve në afat. Duke parë ngarkesën e vitit 2022 në total, vështirësitë në njoftime të palëve, në një proces civil veçanërisht me palë kundërshtare, shtyrje të seancave për shkaqe të ndryshme të arsyeshme, vonesat në kohë të përgjigjeve nga institucionet e ndryshme në tërësinë e tyre çmoj se në raport me të gjitha ky rendiment /siç del dhe nga statistika -1,0818/ është shumë i lartë. Numri i çështjeve të përfunduara në vit 1097 të tilla flasin vetë për rendiment tejet të lartë/në çdo rast brenda 230 ditëve pune/vit janë përfunduar 1097 çështje të kategorive të ndryshme/ (në numrin rreth 230 ditë pune/vit përfshihet dhe leja vjetore, ndërkohë që duhet të merren dhe ditë të tilla si leje paaftësie në punë e gjyqtarit, javët e para të mbartjes në janar, etj). Në këtë rast rendimenti referuar vitit 2022 nuk ka vend që të krahasohen numri i çështjeve të caktuara me ato të përfunduara. Është vetë numri i çështjeve të përfunduara që flet për rendiment shumë të lartë përse kohë është tejkaluar ngarkesa e caktuar -gjërat nuk janë thjesht matematikë por një volum shumë i lartë pune që flet për përkushtim, dedikim dhe impenjim maksimal nga ana ime”*

Edhe kryetari i Gjykatës e vlerëson maksimalisht këtë tregues.

Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, përcaktohet se: *“Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarës. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë se ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzim maksimal, nëse gjyqtarja ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50 % të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli.”*

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezultoi se rendimenti i gjyqtarës për periudhën e vlerësimit është 108 %, përqindje e cila referuar metodologjisë së Pikëzimit pikëzohet me 10 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 10 pikë, duke qenë se ka arritur një rendimet në masën 108 % dhe ndër të tjera ajo e ka tejkaluar standartin minimal sasior në fuqi, mbi 50 %.

2.A.d Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se koha mesatare e arsytimit të vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh është si më poshtë:

- i. Për çështje të kategorisë “civile të përgjithshme me palë kundërshtare” koha mesatare e arsytimit është 20 ditë, pra aq sa se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308/2 i K. Pr. Civile.
- ii. Për çështje të kategorisë “civile të përgjithshme pa palë kundërshtare” koha mesatare e arsytimit është 27 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308/2 i K. Pr. Civile.
- iii. Për çështje të kategorisë “tregtare me palë kundërshtare” koha mesatare e arsytimit është 22 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308/2 i K. Pr. Civile.
- iv. Për çështje të kategorisë “tregtare pa palë kundërshtare” koha mesatare e arsytimit është 8 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308/2 i K. Pr. Civile.
- v. Për çështje të kategorisë “marrëdhënie pune” koha mesatare e arsytimit është 21 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308/2 i K. Pr. Civile.

Nga të dhënat statistikore, të analizuara edhe në Raportin analitik,rezulton se koha mesatare e arsytimit të vendimit është tejkaluar në 3 nga 5 kategoritë, duke rezultuar shumë më e gjatë se afati procedural i parashikuar nga ligji.

Por gjithashtu, rezulton që në 2 nga 3 kategoritë afati i arsytimit është tejkaluar me 1-2 ditë, nga afati i përgjithshëm prej 20 ditë, tejkalim i cili vlerësohet se është papërfillshme, ndërsa në kategorinë e tretë ky afat është tejkaluar me 7 ditë. Pra, nëse do t'i konsiderojmë si të papërfillshme tejkalimet me 1-2 për dy kategoritë “tregtare me palë kundërshtare” dhe “marrëdhënie pune”, koha mesatare e arsytimit rezulton të jetë më e shkurtër se afati

procedural për shumicën e kategorive, pra për 4 nga 5 kategoritë e çështjeve, llogaritje që sipas Metodologjisë së Pikëzimit pikëzohet me 12 pikë.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë, duke u shprehur se: *“Vendimet në pjesen më të madhe janë dorëzuar në sekretari nga një deri në tre ditë të arsyetuara.”*

Megjithatë, sipas Metodologjisë, për të pikëzuar këtë tregues, analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, duke zbatuar një koeficient jo më shumë se 20%.

Në rastin konkret, lidhur me këtë tregues duke pasur në konsideratë, volumin e çështjeve ku rezultoi se gjatë periudhës një vjeçare të vlerësimit gjyqtarja ka dhënë 1093 vendime, nga të cilat 194 janë për çështje me palë kundërshtare dhe 899 janë për kërkesa civile, si dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, konkretisht kohën angazhimit të gjyqtarës në gjykimet gjatë orarit zyrtar në ditët e javës, angazhimin e saj si anëtar i trupit gjykues, vlerësoj që për këtë tregues gjyqtarja të vlerësohet në nivelin maksimal të pikëzimit, që i korespondon pikëzimit me 15 pikë.

KONKLuzioni

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar klasifikohet si *“Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”* dhe gjyqtarja duhet të pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi; Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin *“Koha mesatare e arsytimit të vendimit gjyqësor përfundimtar”* vlerësohet se koha mesatare e arsytimit të vendimit duhet të konsiderohet më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve, e për këtë arsye gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë.

2.B AFTËSIA PËR TË KRYER PROCEDURAT GJYQËSORE.

2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive.

Referuar tabelave me të dhëna statistikore dhe të dhënave që pasqyrohen në Raportin Analitik, rezulton se ka mungesë të të dhënave për numrin e seancave gjyqësore për të gjitha çështjet pasi këto të dhëna nuk gjenerohen në mënyrë elektronike. Sipas Metodologjisë së Pikëzimit, treguesi i numrit të seancave për çështje bëhet pjesë e vlerësimit etik dhe

profesional kur statistikat mundësohen ne rrugë elektronike. Nëse kjo nuk është e mundur, ky tregues për vlerësimin dhe zvarritjen e gjykimeve, identifikohet dhe vlerësohet vetëm për çështjet e zgjedhura me short.

Referuar sa më sipër, për vlerësimin e këtij treguesi, në mungesë të të dhënave për numrin e seancave për të gjitha çështjet, të dhënat e analizuara i referohen 5 dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, të cilat janë çështje me palë kundërshtare⁸⁸. Referuar Raportit Analitik, rezulton se rezulton se në 5 dosjet e përzgjedhura me short rezulton se janë zhvilluar **60 seanca gjithsej, nga të cilat 30 seanca përgatitore dhe 30 gjyqësore, ku këto të fundit janë zhvilluar për vetëm 4 dosje, pasi për një çështje është vendosur shpallja e moskompetencës tokësore në seancë përgatitore**. Sa më sipër, numri mesatar i *seancave gjyqësore* është **7.5 seanca**.

Nga vëzhgimi i dosjeve të çështjeve të përzgjedhura me short evidentohet se gjyqtarja përgjithësisht ka kryer në mënyrë efektive veprimet për vënien në lëvizje të çështjes, ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që u drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë. Konstatohet nga aktet në dosjet burim vlerësimi se gjyqtarja për çdo çështje ka disponuar me urdhër ose vendim për caktimin e datës së shqyrtimit të çështjes, duke caktuar seancën e parë përgatitore dhe atë gjyqësore dhe duke pasqyruar në këtë akt urdhërimin e sekretarisë gjyqësore për kryerjen e njoftimeve të palëve ndërgjyqëse, sipas kriterëve të parashikuara në K.Pr.Civile.

Seancat përgjithësisht janë shtyrë për shkaqe të ndryshme procedurale të tilla si: shtyrë arsye shëndetësore të gjyqtarës, gjyqtarja ka qenë me leje vjetore, për njoftimin e palëve që nuk kanë dijeni për seancën; për njoftimin e personit të tretë, për njoftimin e avokatit të palës së paditur, për shkak të tejkalimit të afatit dhe orës së vonë, për paraqitjen e provës nga pala e paditur; për listimin e provave, për t'i dhënë kohë palëve për përgatitjen e bisedimeve përfundimtare, për paraqitjen e dëshmitarit; për paraqitjen e provave nga pala e paditur, për shpalljen e vendimit të arsyetuar.

Pra, në tërësi, shtyrjet e seancave gjyqësore kryesisht kanë qenë për shkaqe objektive, shumicën e raste të pavarura nga veprimet e gjyqtarës së çështjes, si dhe për të kryer veprimet e nevojshme procedurale me qëllim zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe respektimin e të drejtave procedurale të palëve dhe pjesëmarrësve në gjykim. Megjithatë konstatohet se jo gjithmonë gjyqtarja ka marrë masa, për zhvillimin e një gjykimi të pandërprerë, ashtu siç parashikon Kodi i Procedurës Civile, sidomos me ndryshimet që ky kod ka pësuar me ligjin nr. 38/2017, i cili e ka normuar veprimet që kryhen nga gjyqtari pa caktuar seancë, ato që kryhen në seancë përgatitore, si dhe veprimet që kryhen në seancë gjyqësore, ku paraprakisht

⁸⁸ Në Metodologjinë e pikëzimit lidhur me këtë tregues parashikohet se;” Për të pikëzuar këtë tregues vlerësuesi përcakton fillimisht numrin mesatar të seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh (civile, administrative, penale, dhe sipas shkallëve të gjykimit), duke përfshirë ato pa palë ndërgjyqëse”

janë përcaktuar provat që do të merren në shqyrtimin gjyqësor, duke e kufizuar mundësinë e marrjes së provave të reja në seancë gjyqësore, të cilat nuk janë paraqitur që në veprimet paraprake, apo së bashku me deklaratën e mbrojtjes. Kodi i Procedurës Civile në nenin 186 i K.Pr.Civile ka parashikuar rastet se kur mund të merren prova të reja. Kryerja e të gjitha këtyre veprimeve të nevojshme të parashikuar në ligj, kanë synuar pikërisht zhvillimin e një gjykimi të pandërprerë, duke përfunduar në një seancë gjyqësore, apo në një numër të vogël seancash gjyqësor, siç mund të jetë shtyrja për të paraqitur pretendimet e fundit me shkrim, apo shtyrja për shpalljen e vendimit.

Konkretisht në dy çështje, konstatohet se gjyqtarja ka ndërprerë seancën gjyqësore, me arsyetimin e tejkalimit të afatit të caktuar⁸⁹, dhe në një rast të tjera është shtyrë për listimin e provave⁹⁰. Gjithashtu, konstatohet se në dy dosje gjyqësore, gjyqtarja ka shtyrë seancën me qëllim paraqitjen e provave të reja nga palët në proces, të cilat nuk janë paraqitur që në veprimet paraprake, apo në seancë përgatitore, pa u marrë vendimi për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, duke mos arsyetuar mbi shkaqet që kanë çuar në mosmarrjen e këtyre provave më parë, sipas nenit 186 të K.Pr.Civil⁹¹, çka tregon një administrim jo shumë efikas, me qëllim vijimin e një gjykimi të pandërprerë.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin mesatar. Gjyqtarja ka parashtruar se: *Është e vërtetë që kemi të bëjmë me tregues të vlerësueshëm në pikëpamje matematikore (numër seancash) por në çdo rast për efekt vlerësimi dhe pikëzimi kjo nuk mund të shkëputet dhe të mos trajtohen rrethanat dhe shkaqet e shtyrjeve të seancave. Koncepti "seancë joproductive" duhet të vlerësohet me objektivitet. Dhe këtu duhen theksuar shkaqet e shtyrjeve të seancave të cilat të tilla mund të jenë të lidhura me palët ndërgjyqëse: sëmundje, kërkesë për përfaqësim nga avokat, kërkesë për marrje provash të reja dhe veçanërisht për marrje provash të subjekt shtetëror apo privat që kërkon dhe një kohë më të gjatë, kërkesa të avokatëve për shtyrje seance për shkaqe shëndetësore apo pjesëmarrje në procese të tjera gjyqësore,bojkote(i vitit 2022 që zgjati në kohë), shkaqe shëndetësore të miat si gjyqtar i çështjes,etj.*

Në shtyrjet e seancave gjykata ka marrë në shqyrtim kuptohet shkakun dhe e ka vlerësuar atë në raport me vetë çështjen, momentin procedural në të cilin ndodhet, sjelljen e palëve ndërgjyqëse/pra nëse kërkesa për shtyrje seance është qëllim në vetvete për zvarritje gjykimi-në raste të tilla kam marrë masat përkatëse duke iu tërhequr vëmendjen verbalisht apo me shkresë palëve që të marrin masa pasi një shkak i tillë në vijim nuk do konsiderohet i arsyeshëm. Po ashtu shkaqe shtyrje janë dhe vetq njoftimet e palëve nga ana e nëpunësve të gjykatës apo të postës shqiptare ku jemi përballur me rrethana të tilla që marrin dijeni fillimisht në adresën e padisë apo të gjendjes civile dhe në vijim rezultojnë të larguar/në

⁸⁹ Dosjet që i përkasin vendimit nr. 2486, datë 09.05.2022 dhe vendimit nr. 4960, datë 03.10.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁹⁰ Vendimi nr.4960, datë 03.10.2022 e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁹¹ Neni 186 i K.Pr.Civile, i ndryshuar me ligjin nr.38/2017, në fuqi në kohën e regjistrimit të çështjes, parashikon se ; » *Pas urdhrimit të gjyqtarit të vetëm për caktimin e seancës gjyqësore, sipas nenit 158/c, të këtij Kodi, nuk mund të kërkohen prova të reja dhe të pretendohen fakte të reja, përveçse kur: a) pala e interesuar provon se, pa fajin e saj, nuk ishte në gjendje të paraqiste këto fakte dhe/ose prova të reja më parë; b) pala e interesuar provon se nuk mund të ishte në dijeni të fakteve dhe/ose provave të reja; c) ekziston një interes publik për pranimin e provave të reja. 2. Kjo dispozitë nuk zbatohet për marrjen e pohimit gjyqësor ose jashtëgjyqësor. »*

këto raste nga gjykata i është ridërguar njoftim palës duke i bashkangjitur dhe njoftimin e mëparshëm ku ka dijeni për tu orientuar nëpunësi i gjykatës apo postës, apo është bërë ankimi verbal pranë kryesisë së gjykatës lidhur me rastin, etj.

Ka vlerë të theksohet se me gjithë përpjekjet maksimale nga ana ime është e vështirë, ndodhur përpara një ngarkese shumë të madhe dhe tërësisë së aktorëve, të mund të menaxhohet plotësisht situata; shpesh nga nëpunësit e postës nuk kthehen fletëthirrjet e dërguara nga gjykata apo dhe nga nëpunësit/ftuesit e gjykatës. Shpesh herë jam përballur me ta duke i kërkuar llogari ftuesave-nëpunësit të gjykatës mbi fletëthirrjet- lidhur me vonesat në njoftim, apo mosdërgimin e tyre, etj me qëllim në çdo rast të minimizimit të seancave joproductive.”.

Referuar shpjegimeve të gjyqtarës, rezulton se për katër çështjet me palë kundërshtare, për të cilat janë zhvilluar 30 seanca gjyqësore, 2 seanca janë shtyrë për shkak të COVID 19 dhe 5 seanca për shkak të mosparaqitjes në punë të gjyqtarës për arsye shëndetësore apo për kryerjen e lejes së zakonshme. Kështu, nga një rillojaritje, duke zbritur nga numri i përgjithshëm i seancave, 7 seancat të cilat nuk janë çelur, rezulton se numri mesatar i seancave është 5.75.

KONKLuzioni

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, për treguesin “Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve me palë kundërshtare të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 7.5 seanca dhe përgjithësisht gjyqtarja ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave joproductive, për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave, shkalla e aftësisë duhet të vlerësohet në nivel mesatar, duke e pikëzuar me 9 pikë.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive”, vlerësohet se aftësia e gjyqtarës për këtë tregues është mesatare dhe pikëzohet me 9 pikë.*

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Referuar Raportit Analitik dhe dosjeve të përzgjedhura për vlerësim, rezulton se gjyqtarja në përgjithësi ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për kryerjen e veprimeve paraprake, për caktimin e seancës përgatitore dhe/ose gjyqësore pas caktimit të çështjes me short duke iu referuar rregullave dhe gjykimit sipas kategorive të çështjeve. Konkretisht gjykata ka nxjerrë urdhëri për kryerjen e veprimeve paraprake sipas nenit 158 të K.Pr.Civile,

duke u shprehur me vendim si për njoftimin e akteve dhe kërkesë padisë palëve të paditura, në funksion të lëshimit të deklaratës së mbrojtjes, por njëkohësisht edhe për kalimin e çështjes në seancë përgatitore (*neni 158/b i K.Pr.Civile*). Në çështjen me objekt- *përvajtues gjyqtari*, ka nxjerrë urdhërin për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, konform nenit 72 e vijues të K.Pr.Civile.

Pas kryerjes së veprimeve paraprake, gjyqtarja ka vendosur caktimin e seancës përgatitore, dhe përgjithësisht, nga përmbajtja e vendimeve, konstatohet të jetë arsyetuar sipas parashikimeve të nenit 158/b të K.Pr.Civile duke arsyetuar; psh *pasi ka konstatuar ezaurimin e veprimeve paraprake, për të trajtuar rrethanat e çështjes në tërësi dhe betimin e ekspertit, si dhe të trajtohet kërkesa për thirrjen e personit të tretë, ka vendosur të caktojë seancën përgatitore; me qëllim trajtimin e kërkesës për pezullimin e veprimeve përmbartimore; për rregullimin e objekti i kërkimit; për të trajtuar kërkesën e palës paditëse për shpalljen e moskompetencës.*

Në seancë përgatitore, konstatohet se gjyqtarja ka marrë vendimet e ndërmjetme të parashikuara nga neni 158/b të K.Pr.Civile, konkretisht për kalimin procedural të palëve, sipas nenit 199 të K.Pr.Civile, për pranimin e kërkesës për saktësim/ ndryshim objekti padie, sipas nenit 185 të K.Pr.Civile, për caktim eksperti dhe caktimin e detyrave të tij, për shtimin e ndërgjyqësisë sipas nenit 161/c të K.Pr.Civile, për veçimin e kërkimeve të paraqitura nga pala paditëse, dhe në përfundim për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, duke i konsideruara të plota aktet e paraqitura nga palët apo të marra kryesisht nga gjykata. Nga dosjet burim vlerësimi konstatohet se gjyqtarja përgjithësisht ka caktuar një numër të lartë të seancave përgatitore.

Pas ezaurimit të seancës përgatitore, gjyqtarja ka marrë vendimin për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore konform nenit 158/ç të K.Pr.Civile, dhe në dosje ndodhet i administruara dhe kopja e vendimit/ urdhërit të arsyetuar.

Në çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtarja jo vetëm i ka vënë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore duke caktuar seancën, por duke treguar edhe kujdesin për marrjen e masave për njoftimin e palëve me qëllim zhvillimin e seancave gjyqësore efektive. Gjithashtu, rezulton se të gjitha veprimet procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të dokumentuara. Drejtimi i procesit gjyqësor përgjithësisht ka qenë i rregullt sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligj për gjykimin në shkallë të parë (*neni 171 e vijues të K.Pr.Civile*).

Gjatë zhvillimit të gjykimit, gjyqtarja tregon kujdes të posaçëm për verifikimin e paraqitjes së palëve, mbrojtësve, relatimin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqet e mosnjoftimit të palëve, shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, zhvillimin e gjykimit në mungesë të të paditurve, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar, dhënien e fjalës palëve për parashtrimin dhe paraqitjen e fakteve dhe të provave,

shtyrjen e seancave gjyqësore duke pasqyruar shkakun në çdo rast si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (*njoftimin e palëve, kryerjen e komunikimit me institucionet e tjera, etj*). Gjithmonë gjyqtarja shpall trupin gjykues dhe vendos, sipas rastit, me urdhër apo vendim kalimin në seancë gjyqësore. Drejtimi i seancës zhvillohet në përgjithësi nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre, si dhe me arsyet e vendimmarrjes. Gjithashtu rezultoi që gjykata ka disponuar me vendime të ndërmjetme mbi çdo kërkesë të parashtruar nga palët në gjykim apo edhe vendimet e ndërmjetme të marra kryesisht si ato për marrjen e provave nga të tretë apo kryerjen e aktit të ekspertimit teknik.

Në dosje të vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur me vonesa të vogla. Pavarësisht kësaj, nuk ka rezultuar në asnjë rast që vonesa të jetë bërë shkak për moszhvillimin e seancës gjyqësore (përveç dy rasteve kur seancat janë ndërprerë për tu shtyrë për shkak të tejkalimit të afatit dhe orës së vonë, megjithëse ka rezultuar se nuk ka përfunduar në orarin zyrtar i punës, por më parë).

Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, mbajtur me regjistrim audio si dhe dokumentohen me shkrim nga sekretarja gjyqësore.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë duke theksuar se : *“Në këtë tregues e vlerësoj veten "Shumë e lartë” përsa kohë në vitin 2022 kemi një situatë atipike për gjyqësorin e diktuar sikurse dhe parashtruar nga shkarkimet e gjyqtarëve për shkak të vendimeve të KPK, apo dorëheqjeve, etj. Gjyqtarët e shkarkuar nga vetingu/apo të dorëhequr kanë dorëzuar tërësinë e dosjeve të tyre të cilat janë shortuar të të gjithë gjyqtarët e tjerë (përfshirë dhe mua). Gjyqtarët e mbetur kanë marrë menjëherë (sapo largohej gjyqtari nga vetingu) sasi të mëdha dosjesh në proporcion kjo të numrit të dosjeve të dorëzuara dhe gjyqtarëve të seksionit civil/tregtar të gjykatës ku bëj pjesë dhe unë. Po ashtu numri i çështjeve të reja të ardhura është përballuar nga numri i paktë i gjyqtarëve të mbetur në detyrë. Thënë sa më lart ka qenë në pamundësi tërësisht objektive vënia në lëvizje të menjëhershme e dosjeve të marra përgjatë këtij viti - për shkak të pamundësisë së studimit paraprak të tyre dhe për shkak se vënia menjëherë në lëvizje e të gjithë dosjeve vështirëson shumë veprimet e mëtejshme të miat si gjyqtare por dhe të stafit /sekretares gjyqësore. Nga ana ime dhe sekretares gjyqësore caktuar pranë meje ka pasur impenjim maksimal për të mundësuar kryerjen e veprimeve procedurale efektive dhe në kohë, duke marrë parasysh konstatimin dhe caktimin e afateve për të metat e padisë, njoftimin e akteve apo deklaratës së mbrojtjes, planifikimin dhe zhvillimin e seancave përgatitore efektive, etj. Po ashtu janë marrë të gjithë masat konkrete për dokumentimin e vendimeve dhe veprimeve të tjera procedurale. Në dosjet gjyqësore gjejnë pasqyrim hap pas hapi nëpërmjet akteve shkresore dhe regjistrimeve audio të gjithë veprimet e kryera prej meje: që nga veprimet paraprake në dhomë këshillimi, nga seancat përgatitore (veçanërisht në rastet kur urdhërohen nga ligji), dhe deri në përfundim të gjykimit - shpalljes së vendimit. Gjithmonë kam pasur në fokus të punës time drejtimin e një procesi të rregullt gjyqësor, duke orientuar drejt debatin mes palëve, dëgjimin e palëve ndërgjyqëse, dhënien e*

mundësisë për tu shprehur brenda objektit të çështjes në kuadër të parimit të kontradiktoritetit, orientimin dhe kërkimin prej tyre që të japin shpjegime rreth natyrës së mosmarrëveshjes, pyetjet që iu drejtojnë atyre mundësojnë në një identifikim të plotë të natyrës së çështjes dhe ligjit të zbatueshëm në funksion të plotë të dhënies së një vendimi të drejtë.”

Gjyqtarja dhe kryetari i Gjykatës e kanë vlerësuar maksimalisht këtë tregues.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka treguar shkallë të lartë aftësie në këtë tregues, evidentuar përgjithësisht në shpejtësinë dhe korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit të seancave përgatitore apo gjyqësore, duke respektuar përgjithësisht standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur përgjithësisht me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit civil: që kanë të bëjnë me kryerjen e veprimeve përgatitore efektive dhe në kohë, duke marrë parasysh njoftimin e akteve apo deklaratës së mbrojtjes, planifikimi dhe zhvillimi i seancave përgatitore kur është e nevojshme, dokumentimi i vendimeve dhe veprimeve të tjera procedurale apo me ndjekjen e fazave në të cilat kalon shqyrtimi gjyqësor.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarës për treguesin “Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 20 pikë.*

2.C AFTËSIA E GJYQTARES PËR TË ADMINISTRUAR DOSJEN GJYQËSORE.

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se aktet e dosjeve janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur përgjithësisht, të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Pavarësisht se nuk ka një rregullim që të përcaktojë në mënyrë të shprehur mënyrën e renditjes së akteve në dosjen gjyqësore, renditja duhet të jetë e tillë që të lehtësojë aksesimin e saj. Në këtë kuptim përgjithësisht renditja ka filluar me aktet që kanë vënë në lëvizje gjykatën, aktet e paraqitura nga palët para fillimit të seancave, veprimet dhe vendimmarrjet e gjykatës gjatë veprimeve paraprake, nëse ka. Më pas kalohet tek procesverbalet, parashtrimet e palëve etj., gjithmonë sipas datës së zhvillimit të seancës. Në rastin konkret renditja sipas llojit të akteve procedurale por e ndërthurur kjo edhe me veprimet procedurale të kryera nga gjyqtarja gjatë gjykimit, është dhe konsiderohet si një mënyrë që e bën të lehtë dhe të aksesueshme dosjen. Brenda kategorisë, aktet renditen sipas

datave (*njoftimet, shkresat, procesverbalet e seancave*). Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numëruara dhe mund të shfrytëzohen pa asnjë vështirësi.

Duke iu referuar mënyrës së renditjes së akteve me qëllim që ajo të jetë lehtësisht e shfrytëzueshme, konstatohet se renditja e akteve është bërë në rastin konkret sipas llojit të akteve procedurale në varësi të përpiluesit ku fillimisht janë aktet e palëve sipas rendit historik e më pas veprimet e vendimet e trupit gjykues të dokumentuar në akte procedurale sipas datave përkatëse, të kryera gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë, duke u shprehur se: *“Në këtë tregues çmoj se kam një shkallë ‘Shumë të lartë’. Renditja e dosjes bëhet nga ana ime dhe në përputhje të plotë me aktet përkatëse të secilës palë duke filluar nga padia, akte përfaqësimi, prova të palës paditëse, në deklaratën e mbrojtjes, akt përfaqësimi, prova të palës së paditur, e kështu me rradhë sipas palëve pjesëmarrëse në proces; dosja është lehtësisht e kuptueshme, e menaxhueshme dhe e shfrytëzueshme nga subjektet përkatëse që kanë akses në të.”.*

KONKLuzioni

Në tërësi, rezulton se renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin logjik (sipas kategorisë) dhe kronologjike (brenda së njëjtës kategori aktesh), është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të aksesueshme. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numëruara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Bazuar në sa parashtrohet më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 5 pikë.*

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se në dosjet e përzgjedhura me short, është përfshirë vetëm dokumentacioni që i ka shërbyer zhvillimit të procesit gjyqësor konkret, duke filluar nga momenti i shortimit deri në dhënien e vendimit përfundimtar (*njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e çdo seance përgatitore apo gjyqësore, vendimet për caktimin e seancave gjyqësore, vendimet e ndërmjetme të arsyetuara, vendimet gjyqësore*) si dhe aktet e paraqitura nga palët (*kërkesë padia, provat dhe diskutimet përfundimtare të palëve*).

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë të lartë për këtë tregues, pasi në dosjet e vëzhguara nuk rezulton prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete apo mungesa të akteve të që lidhen me çështjen konkrete.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se aftësia e gjyqtares për këtë tregues është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
90	Shkëlqyeshëm

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A ETIKA NË PUNË

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me të dhënat që mund të tregojnë cenimin e etikës apo përgjegjshmërisë në funksion të gjyqtares u konstatuan këto të dhëna:

Referuar informacionit të përcjellë prej Inspektorit të Lartë të Drejtësisë⁹² rezulton se ndaj gjyqtares {...} në periudhën e vlerësimit, viti kalendarik 2022, është depozituar një ankesë:

- Ankesë e ankuesit Z. A. A, e depozituar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 3594 prot., datë 15.09.2021, regjistruar pranë ILD-së me nr. 51 prot., datë 10.01.2022 dhe nr. 51/1 prot., datë 12.01.2022. Pas shqyrtimit të ankesës Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar vendimin nr. 51/3 datë 25.02.2022 ka disponuar “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasi A. A”.

Sikurse rezulton nga shkresat e mësipërme, ankesa ndaj gjyqtares është arkivuar.

Ndërkohë, sa i takon masave disiplinore, rezulton se nuk është depozituar asnjë vendim i tillë prej organeve kompetente dhe për rrjedhojë Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk disponon informacionin e kërkuar.

Gjyqtarja dhe kryetari i Gjykatës e kanë vlerësuar maksimalisht këtë tregues.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të çënojë etikën në punë të tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e etikës së gjyqtares në lidhje me treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 35 pikë.

3.B INTEGRITETI I GJYQTARIT

3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjteti.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, për vitin kalendarik 2022, rezulton se për gjyqtaren {...} është depozituar një ankesë e cila është arkivuar⁹³.

⁹² Shkresa nr. 1047/1 prot., datë 18.04.2023 dhe shkresën me nr. 1047/3 prot., datë 04.07.2023

⁹³ Ankesa nr. 3594 prot., datë 15.09.2021, me ankues A.A, regjistruar pranë ILD-së me nr. 51 prot., datë 10.01.2022 dhe nr. 51/1 prot., datë 12.01.2022. ILD ka vendosur arkivimin me Vendimin nr. 51/3 datë 25.02.2022.

Ndërkohë, sa i takon masave disiplinore, rezulton se nuk është depozituar asnjë vendim i tillë prej organeve kompetente dhe për rrjedhojë Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk disponon informacionin e kërkuar.

Referuar raportit të ILDKPKI, përcjellë pranë KLGJ me shkresën nr. 105/23 prot. datë 27.05.2024, rezulton se në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr.9049, datë 10.04.2003 “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, ligjin nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar si dhe ligjin nr.96/2016 “Për statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konstatohet se për kandidatin {...}:

- a) *Deklarimi është i sakte dhe në përputhje me ligjin;*
- b) *Ka burime të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë;*
- c) *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- d) *Nuk ka kryer deklarinim të rremë;*
- e) *Nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave”.*

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja dhe kryetari e kanë vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicie që të dëshmojë për ekzistencën e shfaqjeve të pahijshme, cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtares, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë favor ose disfavor në lidhje me çështjet në gjykim, apo çdo sjellje tjetër që mund të cenojë integritetin e gjyqtares.

KONKLUZIONI

Për sa më sipër, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të tregojnë për cenim të integritetit të gjyqtares, vlerësohet se gjyqtarja duhet të pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues, pasi prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelljeve të pahijshme, apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtares.

Shkalla e integritetit të gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e integritetit të gjyqtares në lidhje me treguesin “Shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.

3.C PAANËSIA E GJYQTARIT

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuuese.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit pasqyruar në Raportin Analitik, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtarja në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor, akteve të administruara në dosjet e gjykimit, si dhe të dhënave nga vetëvlerësimi i gjyqtares.

Gjyqtarja lidhur me këtë tregues, e ka vlerësuar aftësinë e saj në nivelin shumë të lartë.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

***Shkalla e integritetit të gjyqtares dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares në treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.*

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për periudhën e vlerësimit, viti kalendarik 2022, janë paraqitur dy kërkesa për përjashtimin e subjektit të vlerësimit, të cilat janë rrëzuar. Ndërkohë, rezulton se vetë subjekti i vlerësimit ka paraqitur 7 kërkesa për heqje dorë, nga të cilat 5 janë pranuar.

Gjyqtarja e ka vlerësuar numrin e kërkesave të pranuar për përjashtim si të pakonsiderueshëm, duke shpjeguar se “Vlerësoj se numri i kërkesave për vitin 2022 duke pasur parasysh dhe numrin shumë të madh të ngarkesës është tërësisht insinjifikant (2 kërkesa të dyja të rrëzuara) dhe e vlerësoj ‘Të pakonsiderueshëm’; Në përgjithësi gjatë detyrës sime si gjyqtare kam pasur një numër të ulët të këtyre kërkesave dhe kjo në konfomitet me figurën time në tërësi ,korrektësinë me palët, ndershmërinë, dinjitetin,qëndrimin korrekt në punë, etj duke mos lënë vend për këto kërkitime. Kur kanë qenë shkaqet kam paraqitur dorëheqje referuar rasteve të parashikuara nga ligji”.

KONKLUZIONI

Sa më sipër, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares është “*I pakonsiderueshëm*”, duke qenë se gjatë kësaj periudhe vlerësimi, nuk është paraqitur asnjë kërkesë për përjashtimin e saj.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares”, vlerësohet se ky numër është “I pakonsiderueshëm”, dhe pikëzohet me 15 pikë.

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtares në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A AFTËSIA E KOMUNIKIMIT.

4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja, gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është i qartë dhe transparent. Gjyqtarja gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e qartë, transparente, kuptueshme. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtares për të qartësuar kërkimet e palëve apo orientuar debatin gjyqësor, konstatohet se komunikimi i saj është i drejtpërdrejtë dhe konkret në lidhje me çështjet për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre. Gjithashtu evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë përgjithësisht edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare. Në aktet shkresore drejtuar të

tretëve është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë, koncize dhe duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja dhe kryetari e kanë vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes të jetë i qartë, i drejtpërdrejtë dhe i kuptueshëm.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” vlerësohet “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 25 pikë.

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk konstatohet që gjyqtarja të ketë ceduar në ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale në lidhje me informacionet dhe të dhënat për të cilat ai është në detyrë të dijë për shkak të funksionit.

I njëjti konstatim rezulton edhe nga aktet e dosjeve të përzgjedhura me short, përfshirë këtu regjistrimet e seancave me mjete audio.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja dhe kryetari e kanë vlerësuar këtë tregues në nivel të lartë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja në çdo rast ka respektuar konfidencialitetin dhe të dhënat personale të palëve duke treguar aftësi të larta në drejtim të këtij treguesi.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtarja dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” vlerësohet “E lartë”, dhe pikëzohet me 15 pikë.

4.B AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR.

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezultojnë asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarëve me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Gjithashtu rezultojnë se në ILD është depozituar një ankesë ndaj gjyqtarëve e cila është arkivuar. Ndërkohë, sa i takon masave disiplinore, rezultojnë se nuk është depozituar asnjë vendim i tillë prej organeve kompetente dhe për rrjedhojë Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk disponon informacionin e kërkuar.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja dhe kryetari e kanë vlerësuar këtë tregues në nivel të lartë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezultojnë se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarëve dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarëve në lidhje me treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik nuk rezultojnë të dhëna që negative për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore, ndërkohë që gjyqtarja dhe kryetari e kanë vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezultojnë se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

4.C GATISHMËRIA E GJYQTARES PËR T’U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA.

4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarës në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja {...}, gjatë periudhës së vlerësimit 01.01.2022 - 31.12.2022, ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e pjesëmarrëses. Konkretisht, rezulton se gjyqtarja {...} është angazhuar në cilësinë e pjesëmarrëses në Programin e Formimit Vazhdues në 4 (katër) aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit (nga data 20.09.2022 deri në datë 23.12.2022), gjithsej 4 ditë trajnimi.

Në ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, pika 3 e nenin 5, parashikohet se;” *Periudha e formimit vazhdues duhet të jetë:*

- a) jo më pak se pesë ditë të plota në vit dhe jo më pak se 30 ditë të plota gjatë pesë viteve;*
- b) jo më shumë se 40 ditë në vit dhe 200 ditë gjatë pesë viteve.”* Pra kjo dispozitë përcakton se gjatë një viti kalendarik, gjyqtari duhet të marrë pjesë në trajnimin vazhdues në jo më pak se 5 ditë trajnimi dhe jo më shumë se 40 ditë në vit.

Në Metodologjinë e Vlerësimit lidhur me këtë tregues përcaktohet se; *Në lidhje me pikëzimin e aftësisë së gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera, treguesi i pjesëmarrjes në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, matet duke u bazuar në informacionin me shkrim që përcillet nga Shkolla e Magjistraturës, i cili vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e magjistratit në trajnime. Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime të tjera vlerësohet bazuar në dokumente të dorëzuara prej tij që tregojnë ngritjen profesionale.*

Pikëzimi i këtij treguesi bëhet referuar numrit të trajnimeve, kohëzgjatjes tërësore të tyre në raport me një temë të caktuar. Këshilli konsideron vlerë të shtuar për ngritjen profesionale trajnimet afatgjata, përfshirë edhe trajnimet afatshkurtra të specializuara në një fushë të caktuar, të organizuara në periudha kohore të ndërprera.

Ndërsa në lidhje me pikëzimin përcaktohet se; Pikëzimi bëhet sipas tabelës; për periudhën 3 vjeçare, 15-120 ditë trajnimi pikëzohet me 20 pikë dhe më pak se 15 ditë ose më shumë se 120 ditë trajnimi (<15 ose >120 ditë), pikëzohet me 4 pikë.

Kjo nënkupton që për periudhën 1 vjeçare të vlerësimit të përshpejtuar të detyruar, siç është përcaktuar edhe në ligjin nr.96/2016, periudha e trajnimit vazhdues; 5- 40 ditë trajnimi pikëzohet me 20 pikë dhe më pak se 5 ditë trajnimi ose më shumë se 40 ditë trajnimi në një vit, pikëzohet me 4 pikë.

Sipas ligjit dhe Metodologjisë së pikëzimit, gjyqtarët kanë detyrimin ligjor të ndjekin programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës apo trajtime të organizuar nga institucione të tjera me qëllim ngritjen e tyre profesionale. Në Metodologjin e Pikëzimit ndër të tjera përcaktohet se: *”Gjyqtari duhet t’i kushtojë kohë evoluimit të mendimit juridik dhe jurisprudencës dhe të ndjekë programe trajnimi që nxitin specializimin e tij të organizuara edhe nga institucione të tjera trajnimi në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, të njohura nga Këshilli...”*.

Lidhur me këtë tregues gjyqtarja shprehet: *“Për vitin 2022 jam munduar që të marr pjesë në seminare por kjo e diktuar së pari nga tematika që shfaq interes për profilin (civile/tregtare) dhe e dyta koha e njoftimit të tyre. Përsa më lart për vitin 2022 në kushtet e një ngarkese shumë të lartë (mbi dy mijë çështje në shqyrtim) jam angazhuar kryesisht në datat e fundit të vitit për të cilat kisha mundësi të merrja pjesë dhe tematika me interes. Kam marrë pjesë në katër të tillë ku bën pjesë dhe trajnimi i mentorëve në shtator të vitit 2022/sa më lart janë të dhëna tërësisht të disponueshme nga shkolla e Magjistraturës. Por ajo që duhet të theksoj është që seminari i datës 19.12.2022 me temë "Shpronësimi si kufizim i së drejtës së pronësisë për një interes publik", i parashikuar për tu zhvilluar si një trajnim dy ditor në të cilin do të merrja pjesë, është zhvilluar vetëm në një ditë, pra një ditor, me miratim të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës/duke plotësuar kështu unë detyrimin përkatës; ky informacion disponohet nga shkolla dhe paraqes së bashku me vetëvlerësimin emailin e dërguar⁹⁴. Ritheksoj dhe një herë që interesi për seminare ka qenë i lartë por nuk ka pasur mundësi objektive rakordimi për pjesëmarrje për shkak të ngarkesës shumë të madhe që e kufizon atë”*.

Në seancë plenare edhe për këtë tregues gjyqtarja paraqiti kundërshtime, duke pretenduar se mospjesmarrja në trajnimin vazhdues ka ndodhur për shkak të ngarkesës tepër të lartë në punë gjatë vitit 2022, si dhe faktin se gjatë këtij viti ajo kishte planifikuar 5 ditë trajnimi, por një nga trajnimet e planifikuara në dy ditë është zhvilluar brenda një ditë, dhe se për këtë fakt, mesa ajo kujtohet është njoftuar vetëm ditën e trajnimit. Megjithatë, Shkolla e Magjistraturës ka pasur të planifikuar edhe dy trajnime të tjera deri në fund të vitit, porse ajo nuk ka marrë pjesë për shkak se kanë qenë në të drejtën penale.

⁹⁴ Bashkëlidhur Formularit të Vetëvlerësimit ndodhet një korrespondencë përmes postës elektronike të dërguar nga ptv@magjistatura.edu.al që konfirmon se trajnimi i datës 19 Dhjetor 2022 me temë “Shpronësimi si kufizim i së drejtës së pronësisë për një interes publik” i parashikuar për tu zhvilluar si një trajnim dy ditor është zhvilluar vetëm në një ditë, pra një ditor me miratim të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese të zhvilluara nga Shkolla e Magjistraturës dhe jashtë saj, kryesisht për tema që i përkasin të drejtës civile, gjithsej 4 aktivitete të zhvilluara për 4 ditë, kohëzgjatje e cila është jashtë kufijve 5 deri në 30 ditë në të gjithë periudhën një vjeçare të vlerësimit. Megjithatë, Këshilli vlerësoi se në kushtet kur mosplotësimi i 5 ditë trajnimi ka ndodhur për shkaqe të pavarura nga vullneti i gjyqtarës, pasi gjyqtarja ka planifikuar 5 ditë trajnimi të plota, gjyqtarja duhet të pikëzohet me 20 pikë.

Pjesëmarrja e gjyqtarës në trajnime dhe pikëzimi; Referuar sa më sipër, Këshilli vlerësoi se pjesëmarrja e gjyqtarës në aktivitetet trajnuese të Sh. M dhe trajnime të tjera profesionale do të konsiderohet brenda kufijve 5-30 ditë, dhe për këtë arsye pikëzohet me 20 pikë.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarës për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezulton se gjyqtarja të jetë angazhuar në programin e formimit vazhdues së Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e lehtësuesit apo ekspertit.

Ndërsa referuar dosjes së saj personale si dhe informacionit të paraqitur së bashku me Formularin e vetëvlerësimit të gjyqtarës, rezulton se me vendimin nr. 316, datë 22.07.2021, përditësuar me vendimin nr.242, datë 30.06.2022 e Këshillit të Lartë Gjyqësor është caktuar si mentore për kandidatët për magjistrat pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe me vendimet nr.315, datë 22.07.2021 dhe me nr. 252, datë 07.07.2022 i janë caktuar magjistratë për mentorim për vitin akademik 2021-2022 dhe 2022-2023. Sipas vërtetimit datë 19.04.2024 të lëshuar nga Zv. Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezulton se gjyqtarja {...} Bajo {...} ka qenë gjyqtare përgjegjëse gjatë procesit të praktikës profesionale në periudhat: Nëntor 2021- Shkurt 2022 për kandidatin magjistrat Edison Tatoshaj, Korrik 2022- Tetor 2022 për magjistraten Eglantina Biba, Dhjetor 2022- Shkurt 2023 për kandidatin magjistrat Ervin Kore.

Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur më këtë tregues, përcaktohet se pikëzimi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë, dhe 2 pikë të tjera iu shtohen në vlerësim gjyqtarëve që e kryejnë këtë veprimtari njëkohësisht me veprimtarinë gjyqësore, pavarësisht nga frekuenca e angazhimit.

KONKLUZIONI

Sa më sipër, vlerësoj se për gjyqtaren {...}, duke qenë se gjatë periudhës së vlerësimit është miratuar si gjyqtare udhëheqëse për periudhën 2021-2024, duke iu caktuar edhe gjyqtarë për mentorim për vitin 2022, ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë.

Disponueshmëria e gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë.

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtares në veprimtari ndërinstytucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezulton të ketë të dhëna për këtë tregues.

Në formularin e vetëdeklarimit, gjyqtarja {...} ka deklaruar se: “Ngarkesa e madhe e gjyqësorit, veçanërisht e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë në vitin 2022 ka vështirësuar dhe këto pjesëmarrje..”

Lidhur me këtë tregues në Metodolinë e Pikëzimit parashikohet se:” Gjyqtari mund të dedikojë kohë dhe përpjekje për të përmirësuar sistemin gjyqësor në mënyra të ndryshme. Këto përfshijnë veprimtari jashtë funksionit, me ose pa pagesë, të tilla si: fjalime publike; prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrja në programet e edukimit të komunitetit; bashkëpunimi me Këshillin për përmirësimin e programeve të formimit vazhdues; angazhimi si ekspert në punët e Këshillit për përgatitjen e formave standarde me qëllim rritjen e efikasitetit; kontribute në hartimin e legjislacionit; aktivitete mësimdhënëse për çështje ligjore; bashkëpunimi me grupe interesash të ndryshëm me qëllim rritjen e cilësisë së gjyqësorit dhe ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit, si edhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme në fushën juridike”.

Bazuar në sa parashikohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtaren {...}, ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësi apo aktivitete të tjera.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Angazhimi i gjyqtares në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 3 pikë, pasi nuk rezulton angazhimi i saj në këto veprimtari.

4.C.ç Publikimet ligjore akademike.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtares në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, nuk rezulton që gjyqtarja gjatë periudhës së vlerësimit të ketë publikuar punime akademike.

Në formularin e vetëdeklarimit, gjyqtarja {...} ka deklaruar se nuk ka publikime ligjore.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja nuk ka realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, duhet të pikëzohet me 0 pikë.

Publikimet ligjore akademike dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “Publikime ligjore akademike” nuk rezultojnë publikime të gjyqtares, dhe për pasojë pikëzohet me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI	
AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
93	Shkëlqyeshëm

F- PËRCAKTIMI I NIVELIT TË VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELIN E PËRGJITHSHËM TË VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarës	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarës	90	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	93	Shkëlqyeshëm
Propozimi për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	383	Shkëlqyeshëm

REKOMANDIME

Bazuar në nenin 93, pika 5, shkronja “ç”, të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuara dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandohet që gjyqtarja {...} t’i kushtojë më shumë rëndësi pjesës pasqyrimin të fakteve të çështjes, të qartësisë së vendimit, si dhe të strukturës së vendimeve. Gjithashtu, të mbajë në konsideratë angazhimin e saj në pjesëmarrjen në veprimtari ndër-institucionale, programin e trajtimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, si pjesëmarrës, lehtësues apo ekspert, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit në këto fusha.

SHTOJCA 1
KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE
NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTAREN {...}
PERIUDHA E VLERËSIMIT 2022

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES			Pikët total	Niveli i vlerësimit	
			100	Shkëlqyeshëm	
Treguesit	Burimet	Shkalla e aftësisë	Pikët	Të dhëna për metodologjinë	
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
B. Arsyetimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares	Shumë e lartë	15	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 3 pikë

		3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim			Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES

Pikët total

Niveli i vlerësimit

90

Shkëlqyeshëm

Tregues		Burimet	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë	a. Respektimi i afateve ligjore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i	11-20 %	12	Jashtë afatit: Mbi 40 % - 3 pikë 31-40 % - 6 pikë 21-30 % - 9 pikë

		kryetarit			11-20 % - 12 pikë 0-10 % - 15 pikë
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10 %	5	Jashtë afatit: Mbi 40 %- 1 pikë 31-40 % - 2 pikë 21-30 % - 3 pikë 11-20 % - 4 pikë 0-10 % - 5 pikë
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve	4	Koha mesatare: Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve – 1 pikë Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 2 pikë Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve – 3 pikë Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 4 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve – 5 pikë
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i	+99%	10	Tej standardit : Nën 81%- 2 pikë

		gjqtares 3.Mendimi përfundimtar i kryetarit			Mbi 81-87% - 4 pikë Mbi 87- 93% - 6 pikë Mbi 93-99% - 8 pikë +99% - 10 pikë
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	1.Të dhënat statistikore 2.Vetëvlerësimi i gjyqtares 3.Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve	15	Koha mesatare: Më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 3 pikë Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 6 pikë Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve- 9 pikë Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 12 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 15 pikë
B. Aftësia e	a. Numri mesatar i seancave	1.Të dhënat	Mbi 3 seanca	9	Numri mesatar i seancave

gjqtares për të kryer procedural gjyqësore	gjqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	statistikore/aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	dhe shkallë mesatare e aftësisë		dhe shkalla e aftësisë së gjyqtares: Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët e aftësisë – 3 pikë Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare e aftësisë – 9 pikë 1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë – 15 pikë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	20	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët- 4 pikë Nën mesataren – 8 pikë Mesatare – 12 pikë Mbi mesataren – 16 pikë Shumë e lartë - 20 pikë
C. Aftësia e gjyqtares për të administruar dosjen gjyqësore	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares	Shumë e lartë	5	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët- 1 pikë Nën mesataren – 2 pikë Mesatare – 3 pikë Mbi mesataren – 4 pikë Shumë e lartë - 5 pikë

	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë
3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				100	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtares 3. Vetëvlerësimi i gjyqtares 4. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	35	Shkalla e etikës në punë e gjyqtares: E dobët- 7 pikë Nën mesataren – 14 pikë Mesatare – 21 pikë Mbi mesataren – 28 pikë Shumë e lartë – 35 pikë
B. Integriteti i gjyqtares	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit 4. Të dhënat e raportit të	Shumë e lartë	40	Shkalla e integritetit të gjyqtares : E dobët – 0 pikë Shumë e lartë – 40 pikë

		ILDKPKI			
C. Paanësia e gjyqtares	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	1.Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 2.Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim	Shumë e lartë	10	Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë- 10 pikë
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares	1.Të dhënat statistikore 2.Vetëvlerësimi i gjyqtares 3.Mendimi përfundimtar i kryetarit	I pa konsiderueshëm	15	Numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares: Tejet i lartë – 3 pikë I pa konsiderueshëm – 15 pikë
4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				93	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	1.Vetëvlerësimi i gjyqtares 2.Mendimi përfundimtar i kryetarit 3.Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim	Shumë e lartë	25	Qartësia dhe transparencja e komunikimit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë

		4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short			
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 	I lartë	15	Respektimi i konfidencialitetit: I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë I lartë – 15 pikë
B. Aftësia për të bashkëpunuar	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave 	Shumë e lartë	15	Shkalla e komunikimit: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë

	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë	10	Shkalla e komunikimit: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
C. Gatishmëria e gjyqtares për t'u angazhuar në veprimtari të tjera	a. Pjesëmarrja e gjyqtares në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	1. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës 2. Dosja personale e gjyqtares 3. Dokumente të dorëzuara nga gjyqtarja	5- 30 ditë	20	Pjesëmarrja e gjyqtares: (periudha 1/vjeçare) 5- 30 ditë – 20 pikë <5 ose > 30 ditë: 4
	b. Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	1. Dosja personale e gjyqtares 2. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera	Ka të dhëna	5	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	c. Pjesëmarrja e gjyqtares në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Dosja personale e gjyqtares 4. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen	Nuk ka të dhëna	3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë

		profesionale të gjyqtares			
	ç. Publikimet ligjore akademike	1. Dosja personale e gjyqtares 2. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të saj	Nuk a të dhëna	0	Nuk ka të dhëna – 0 pikë Ka të dhëna – 1 deri në 5 pikë
KËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT			383		
VELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARES			Shkëlqyeshëm		